

## Transparenca dhe Pjesëmarrja në Veprimtaritë Legjislative INTEGRIMI NË BE

Buletin informativ Nr.7

nëntor 2006

### Marrëveshja e tregtisë së lirë mes Shqipërisë dhe BE-së – përfitime apo kosto neto?

*Engjell Skreli, Dr*

Marrëveshja e ndërmjetme mes BE-së dhe Shqipërisë që ka të bëjë me liberalizimin e tregtisë mes palëve hyri në fuqi në fillim të dhjetorit të këtij viti. Në mënyrë disi të papritur, ajo kaloi pa ndonjë reagim të mediatizuar të grupeve të interesit.

Çfarë është marrëveshja e ndërmjetme e tregtisë mes Shqipërisë dhe BE-së? Cilat janë dimensionet e kësaj marrëveshjeje? Cilat janë efektet dhe implikimet për qeverinë dhe grupet e interesit? Këto janë disa nga çështjet e trajtuara në diskutimin vijues.

*Çfarë është marrëveshja e ndërmjetme në kuadër të MSA-së*

Marrëveshja e ndërmjetme, si pjesë e MSA-së, mbulon pjesën e tregtisë në mallra të kësaj marrëveshjeje. Duhet vërejtur se marrëveshja e ndërmjetme mbulon vetëm njërën nga liritë e lëvizjes, atë të lëvizjes së lirë të mallrave duke lënë jashtë lëvizjen e shërbimeve, punonjësve, kapitalit. Për të përfituar nga efektet tregtare, si rregull, këto lloj marrëveshjesh hyjnë në fuqi pa pritur ratifikimin e saj në parlamentet e palëve respektive.

*(vijon në faqen 2)*

### Strategjia e Zgjerimit dhe sfidat kryesore për 2006-2007

*Ditmir Bushati*

Publikimi i Strategjisë së Zgjerimit nga ana e Komisionit European në të njëjtën ditë me Raportin Vjetor për Shqipërinë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor si dhe Turqinë, u përçoll thujse me një heshtje të plotë në Shqipëri, a thua se me firmosjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria i kaluar të gjitha “penge-sat” dhe tashmë pret thjesht ditën e anëtarësimit në BE.

Në të vërtetë përmes këtij dokumenti të rëndësishëm BE-ja ka ripërcaktuar mënyrën se si do ta administrojë valën e re të zgjerimit, kur dihet se vende si Kroacia dhe Turqia janë në procesin e negociatave për antarësim. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka fituar statusin e vendit kandidat, por ende nuk ka marrë një datë zyrtare për fillimin e negociatave. Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Bosnje Hercegovina, Serbia, Mali i Zi shpresojnë të nënshkruajnë një të tillë brenda vitit 2007. Ndërsa për Kosovën ky vit pa mëdys-

*(vijon në faqen 5)*

### Në këtë numër:

1. Marrëveshja e tregtisë së lirë mes Shqipërisë dhe BE-së – përfitime apo kosto neto?

*Engjell Skreli, Dr* *faqe 1-4*

2. Strategjia e Zgjerimit dhe sfidat kryesore për 2006-2007

*Ditmir Bushati* *faqe 1, 5*

3. Nga Veprimtaria e Komisionit Parlamentar të Integrimit

*nëntor 2006* *faqe 1, 6-7*

4. Vlerësimi i pyetësorit mbi “Axhendën Europiane” në Parlamentet Kombëtare

*faqe 7-12*

5. Projektligji “Për Koncesionet”

*faqe 13-21*

6. Takimi 15-të i Grupit Konsultativ BE - SHQIPËRI

Draft axhenda

*faqe 21*

### NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN NËNTOR 2006

Komisioni Parlamentar për Integrimit European për muajin nëntor ka patur aktivitete të ndryshme që i përka-sin fushes e kompetencës së tij.

Veprimtaria legjislative

Gjatë muajit nëntor, Komisioni i Integrimit ka shqyrtuar disa projektligje. Projektligjet, kryesisht, ishin ratifikime të marrëveshjeve ndërkombëtare, si më poshtë vijon:

1. Projektligji: “Për ratifikimin e planit të veprimit kombëtar 2006 – 2010, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA)”

2. Projektligji: “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Hagës, të marrëveshjes së Hagës për rregjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale, 1960”.

3. Projektligji: “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aktin e Gjenevës, të Marrëveshjes së Hagës, për Rregjistrimin Ndërkombëtar të Projekteve Industriale, dhe Rregulloret mbështetur në Aktin e Gjenevës 1999”.

*(vijon në faqen 6)*

## Marrëveshja e tregtisë së lirë mes Shqipërisë dhe BE-së – përfitime apo kosto neto?

(vijon nga faqja 1)

Marrëveshja e ndërmjetme mes Shqipërisë dhe BE-së ka hyrë në fuqi nga 1 dhjetori i vitit 2006.

Në mënyrë të përbledhur, marrëveshja e ndërmjetme mes Shqipërisë dhe BE-së synon krijimin e një zone të tregtisë së lirë mes dy palëve, në një periudhë prej 10 vitesh. Krijimi i zonës së tregtisë së lirë ka si kusht të domosdoshëm eliminimin gradual të gjithë barrierave tarifore e jo-tarifore si dhe evitimin e diskriminimit mes paleve, përfshirë edhe evitimin e diskriminimit fiskal. Evitimi i barrierave dhe diskriminimit përbën një sfidë legislative dhe institucionale, në kuptimin e transpozimit të një korpusi të tërë ligjor dhe ngritjen e institucioneve të afta për zbatimin e tij.

*Marrëveshja e ndërmjetme mes Shqipërisë dhe BE-së, në kuadër të MSA-së*

Marrëveshja e ndërmjetme për tregtinë e lirë ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, synon

- Hapjen e tregjeve të të dy palëve, në bazë të rregullave të OBT-së; krijimin e një zone të tregtisë së lirë në një periudhë tranzitore prej 10 vitesh;
- Eliminimin e të gjitha kufizimeve sasiore, apo masave të tjera me efekt të njëjtë;
- Eliminimin e shkallëzuar të tarifave doganore;
- Përafrimin e legjislacionit tregëtar, nëpërmjet harmonizimit të tij me “acquis communitaires”;
- Eliminimin e diskriminimit fiskal, për të gjitha llojet e taksave dhe tarifave në territoret e të dy palëve.

Marrëveshja e ndërmjetme për tregtinë e lirë ndërmjet Bashkimit European dhe Shqipërisë, përbëhet nga 4 tituj:

- Parimet e përgjithëshme
- Lëvizja e lirë e mallrave:
  - Kapitulli i parë: Produktet Industriale
  - Kapitulli i dytë: Bujqësia dhe peshkimi
  - Kapitulli i tretë: Masat e përbashkëta
- Masat e tjera tregtare
- Masat institucionale, të përgjithëshme dhe përfundimtare

Ajo plotësohet me katër anekse:

- Aneksi I: Tarifatat doganore shqiptare për koncensione për produktet industriale nga Bashkimi European  
 Aneksi II: Tarifatat doganore shqiptare për koncensione për produktet bujqësore nga Bashkimi European  
 Aneksi III: Tarifatat doganore të Bashkimit European për koncensione për produktet shqiptare të peshkut  
 Aneksi IV: E drejta e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare

Pesë protokolle:

Protokolli 1: Çeliku dhe produktet e çelikut

Listë tentativë e përfitimeve dhe kostove të marrëveshjes së ndërmjetme

Përfitime	Kosto
Gamë më e gjerë produktesh cilësore për konsumatorët	Kosto tregtare për biznesin e konsoliduar
Çmime më të ulta për konsumatorët	Kosto tregtare për industrinë foshnjore
Shanse më të mëdha eksporti, nisur nga reduktimi i barrierave por sidomos nga përafrimi i standardeve në tregjet e BE-së dhe ato rajonale	Kosto buxhetore në formën e të ardhurave të munguara buxhetore
Reduktimi i barrierave për biznesin importues	Transferime në formën e rritjes së çmimeve për efekt të mbrojtjes së patentave dhe të drejtave të autorit
Niveli i fushës së lojës për biznesin	
Investimi në teknologji bashkë-kohore si rezultat i ekspozimit ndaj konkurrencës	
Mjedis më terheqës për investimet e huaja direkte	

(vijon në faqen 3)

## Marrëveshja e tregtisë së lirë mes Shqipërisë dhe BE-së – përfitime apo kosto neto?

(vijon nga faqja 2)

Më poshtë diskutohet mbi disa momente të efekteve të marrëveshjesh në rastin e Shqipërisë. Momentet janë zgjedhur për shkak të ndjeshmërisë së tyre për opinionin publik në Shqipëri.

*Marrëveshja e ndërmjetme do të rezultojë në përfitime neto tregtare; përfitimet më të mëdha do të jenë nga reduktimi i barrierave të brendshme*

Gjetjet e disa studimeve të fundit sugjerojnë se vendet në zhvillim – Shqipëria është një vend në zhvillim - kanë përfitime neto tregtare nga marrëveshjet e tregtisë së lirë. Këto përfitime i detyrohen hyrjes në tregjet e eksporteve të vendeve të zhvilluara, në këtë rast në tregjet e BE-së. Ndërkaq, duhet të vërehet se përfitimet nga hyrja në tregjet evropiane do të jenë të kufizuara, të paktën në afatin e shkurtër; eksperiencia e mos-përdorimit të kontigjenteve pa tarifa doganore e ka dëshmuar tashmë këtë. Ndërkaq, përfitimet më të mëdha tregtare lidhen me reduktimin e barrierave të vetë vendeve në zhvillim, në rastin konkret të Shqipërisë. Reduktimi i barrierave tregtare të brendshme do të shoqërohet me rritjen e efikasitetit ekonomike sepse si konsumatorët dhe prodhuesit do të mund të blejnë produkte nga burimet me koston më të ulët.

Eksperiencia e tranzicionit shqiptar tregon se hapja tregtare ka rezultuar në alokimin e faktorëve të prodhimit në sektorët më produktivë. Me fjalë të tjera, produktiviteti total i faktorëve si rezultat i politikës së hapjes tregtare ka qenë faktori kryesor i rritjes ekonomike. Ky faktor vazhdon të ketë akoma një ndikim të konsiderueshëm në rritjen ekonomike.

*Debati i zakonshëm i barrierave tarifore: efektet e marrëveshjes do të jenë modeste*

Palët në marrëveshjen e ndërmjetme bëjnë konkencione të rëndësishme lidhur me reduktimin e barrierave tarifore, siç tregohet në kutinë e mëposhtme:

*Tarifat doganore në MSA*

Në bazë të MSA-së, tregu evropian hapet plotësisht për produktet industriale shqiptare. Këto produkte mund të hyjnë në tregun evropian praktikisht pa tarifa doganore. Si rregull, edhe produkteve bujqësore shqiptare u janë bërë konkencione të rëndësishme. Hyrja e tyre është e lirë, me përjashtim të gjedhëve dhe mishit të gjedhit, sheqerit, verës, disa lloje perimesh dhe frutash, disa lloje peshqish të ujrave të ëmbla dhe të detit dhe konservave të acugeve dhe sardeleve. Për produktet e mësipërme janë bërë ndërkaq konkencione të rëndësishme sasiore.

Tregu shqiptar do të hapet për produktet industriale përsa i përket tarifave doganore, me përjashtim të disa produkteve të konsideruara të ndjeshme, për të cilat tarifa doganore do të shkojnë në zero pas pesë vitesh nga hyrja në fuqi e marrëveshjes. Produktet e

ndjeshme shqiptare janë kripa e detit, plehrat fosfatike, hidrokarburet, sapuni e detergjentet, produktet plastike, çimentoja, tullat e tjegullat, gomata e përdorura, hekuri i ndërtimit, tubat e hekurit me saldim, lëkurat dhe këpucët, mobiljet e drurit. Konkencione të rëndësishme bëhen edhe në hyrjen në tregun e produkteve bujqësore. Këtu, produktet ndahen në disa kategori: produkte bujqësore për të cilat tarifat doganore hiqen në mënyrë të menjëhershme, produkte bujqësore tarifave doganore të të cilave shkojnë në zero brenda katër vitesh nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, dhe kuotë tarifore prej 20 mijë tonë për grurin.

Burimi: Ministria e Ekonomisë  
Debati lidhur me liberalizimin e tregtisë në Shqipëri ka qenë vazhdimisht i shmangur në favor të efekteve të reduktimit të barrierave tarifore mbi prodhimin vendas. Shqetësimi ka qenë: heqja/reduktimi i tarifave doganore do të shkatërrojë prodhimin vendas. Në fakt, hyrja në fuqi e marrëveshjes së ndërmjetme për tregtinë e lirë mes Shqipërisë dhe BE-së pritet të ketë efekte modeste mbi prodhimin vendas, për disa arsye:

- Mbrojtja tarifore është modeste

Tarifat doganore për produktet industriale e bujqësore të importit kanë qenë modeste me një trend zbritës. Kujtojmë këtu se tarifa maksimale doganore sot është vetëm 15%.

- Trendi liberalizues i ka ndihmuar binzeset të përgatiten për liberalizim të mëtejshëm

Shqipëria është antare e OBT-së që nga viti 2000. Ajo ka nënshkruar dhe është duke zbatuar një numër marrëveshjesh të tregtisë së lirë me vendet e rajonit. Përveç kësaj, biznesi ka marrë sinjale të vazhdueshme se hapja tregtare është një realitet i patjetërsueshëm. Gjithë ky trend dhe kjo atmosferë e ka ndihmuar biznesin të investojë në teknologji të reja që mund t'i rezistojnë konkurrencës së jashtme.

- Produktet e ndjeshme janë mbrojtur në mënyrë të përshtatshme

Procesi i liberalizimit është shoqëruar me një konsultim adekuat të grupeve të interesit, të cilët shpesh kanë qenë edhe antarë të grupeve negociatore. Një proces i tillë ka krijuar mundësinë që produktet më të ndjeshme bujqësore dhe industriale të mbrohen në mënyrë të përshtatshme.

*Kostot tregtare për biznesin nga praktikatat e pandershme në tregti*

Bashkimi evropian vazhdon të ketë një politikë të subvencionit të eksporteve dhe të subvencionit të brendshëm, megjithëse jo-specifik. Kjo lloj politike

(vijon në faqen 4)



## Marrëveshja e tregtisë së lirë mes Shqipërisë dhe BE-së – përfitime apo kosto neto?

(vijon nga faqja 3)

dhe politikat e mundshme të dumpingut të adoptuar nga firma private mund të dëmtojnë “padrejtësisht” biznesin shqiptar.

*Kostot e lidhura me mbrojtjen e patentave dhe të drejtave të autorit*

Marrëveshja kërkon që në një periudhë 5-vjeçare nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, të drejtave të pronësisë intelektuale t’iu bëhet një mbrojtje e përafërt me mbrojtjen që u bëhet në vendet e BE-së. Kjo do të thotë që kompanitë evropiane të përfitojnë nga shitesa në çmime për ilaçet, programet e kompjuterave, muzikën dhe videot dhe shumë gjëra të tjera. Si rezultat i kësaj, konsumatorët dhe bizneset duhet të paguajnë shumë më tepër për këto produkte se çdo të paguanin nëse këto produkte nuk do të mbroheshin. Çmimi më i lartë përbën një kosto në formën e transferimit të parave nga Shqipëria në vendet e BE-së.

*Kostot buxhetore*

Hyrja në fuqi e marrëveshjes së ndërmjetme pritet të rezultojë edhe në kosto buxhetore sepse të ardhurat nga doganat pritet të bien. Këtu ka nevojë të bëhet një sqarim; duhen dalluar të ardhurat nga doganat nga të ardhurat nga tarifatat doganore. Nëse të ardhurat nga të ardhurat doganore do të bien, të ardhurat nga doganat do të bien shumë pak sepse TVSH-ja që mblidhet në doganë do të vazhdojë të mblidhet aty. Duhet vërejtur se megjithëse humbjet nga doganat janë reale dhe të rëndësishme, duket se ato nuk përbëjnë ndonjë problem të madh. Këtë e kanë dëshmuar gjithë buxhetet e përgatitura nga viti 2000, ku megjithë rënien e të ardhurave nga doganat, të ardhurat buxhetore kanë ardhur duke u rritur në mënyrë të konsiderueshme.

*Cilat janë implikimet për politikat publike dhe për grupet e tjera të interesit*

Rritja e përfitimeve dhe ulja e kostove të marrëveshjes së ndërmjetme do të kërkonte një rol aktiv të qeverisë dhe grupeve të tjera të interesit, përfshirë në drejtimet e mëposhtme:

*Ndërtimin gradual të sistemit të konkureshmërisë*  
Materializimi i përfitimeve të eksportit do të kërkonte përpjekje konstante, afat-gjata, të krijimit të një sistemi ekonomik konkures. Në këtë kontekst, kërkohen përpjekje në nivelin e kompanisë, tregjeve dhe infrastrukturave e politikave qeveritare.

Në këtë projekt të madh të krijimit të një sistemi konkures, qeverisë i takon të përmbushë funksione të rëndësishme në nivelin mezo-ekonomik, pra në ndërtimin e infrastrukturave dhe

përmirësimin e funksionimit të tregjeve. Ndërkaq, rritja e konkureshmërisë ka si element qënësor edhe politikat e kompanive private.

*Reduktimi i barrierave tregtare si kusht për realizimin e përfitimeve tregtare*

Përfitimet tregtare janë të lidhura ngushtë me reduktimin e barrierave të brendshme për të siguruar që inputet dhe produktet lëvizin lirisht, pa barriera. Në këtë kontekst, qeveria duhet të përmbushë funksione të pazëvendësueshme lidhur me reduktimin e barrierave, sidomos barrierave jo-tarifore. Reduktimi i barrierave të panevojshme teknike në tregti, reduktimi i barrierave të panevojshme sanitare e fitosanitare, eliminimi i gjithë masave-barriera ekuivalente me kufizimet sasiore e barriera të tjera janë kushte për materializimin e efekteve tregtare të marrëveshjes.

*Ngritjen/forcimin e institucioneve e tregtise se drejte, pjese e rregullave të lojës në tregti*

Praktikat e tregtisë së pandershme të subvencionit të eksporteve, mbështetjes së brendshme, dumpingut, etj. duhen adresuar në mënyrë institucionale. Në këtë kuadër, rëndësi të dorës së parë merr ngritja e institucioneve funksionuese të korregjimit të tregtisë së pandershme. Krijimi i kuadrit ligjor dhe krijimi/forcimi i institucioneve të korregjimit të tregtisë së pandershme është para së gjithash përgjegjësi e qeverisë. Ndërkaq, edhe biznesi ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në këtë drejtim, pasi si rregull është biznesi që duhet të nisë procedurën. *Përdorimin e instrumentave alternative për mbështetjen e prodhimit vendas me potenciale konkures*  
Reduktimi i mbështetjes së prodhimit vendas nëpërmjet instrumentit të tarifave doganore është një arsye me shumë për të përdorur tashmë instrumente alternative, njëri prej të cilëve është ai i ndihmës shtetërore. Bashkimi evropian njuh dhe inkurajon përdorimin e këtij instrumenti, të quajtur “ndihmë shtetërore” për mbështetjen e prodhimit vendas.

**Në vend të konkluzionit**

Marrëveshja e ndërmjetme si pjesë e MSA-së me BE-në pritet të ketë përfitime neto tregtare. Por duhet vërejtur se realizimi i këtyre përfitimeve do të jete i mundur në kushtet e një roli aktiv të qeverisë dhe biznesit. Ndërtimi i një sistemi të konkureshmërisë së produkteve shqiptare, reduktimi i barrierave, sidomos atyre jo-tarifore dhe ngritja/forcimi i institucioneve të tregtisë së drejtë janë disa nga drejtimet që do të ndikojnë në materializimin e efekteve tregtare.

Ndërkaq, marrëveshja pritet të ketë një kosto neto në formën e transferimit vleror drejt kompanive të BE-së në formën e çmimeve më të larta për efekt të mbrojtjes së patentave dhe të të drejtave të autorit, si dhe kosto buxhetore në formën e të ardhurave të munguara.

## Strategjia e Zgjerimit dhe sfidat kryesore për 2006-2007

(vijon nga faqja 1)

hje mund të konsiderohet si viti i statusit të saj.

### *Fundi i zgjerimit të pestë*

Strategjia e Zgjerimit e vitit 2006-2007, në dallim nga ajo e vitit të shkuar përkon me përfundimin e zgjerimit të pestë, me anëtarësimin në BE, të Bullgarisë dhe Rumanisë më 1 Janar 2007. Në të njëjtën kohë, përfundimi i zgjerimit të pestë dhe impaktet e antarësimit të dhjetë vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore në vitin 2004, i kanë dhënë mundësi vetë BE-së të nxjerrë "mësimet" e duhura.

Procesi i zgjerimit është konsideruar më të drejtë si mekanizmi gjenerues dhe zhvillues i vetë BE-së dhe në të njëjtën kohë si përcues i vlerave europiane në vendet kandidatë që synojnë të bëhen pjesë e "klubit". Është kjo arsyeja që dhjetë vendet e antarësuara në vitin 2004 sot kanë një nivel shumë të mirë të përputhshmërisë me standardet e përcaktuara nga legjislacioni dhe politikat komunitare. Institucionet komunitare kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe shtimi i radhëve jo vetëm ka pasuruar nga pikpamja kulturore BE-në, por i ka dhënë një dimension më të madh në arenën ndërkomëtare.

Zgjerimi ka ndihmuar fuqizimin dhe modernizimin e ekonomisë, duke shtuar mundësitë për investime dhe tregti dhe duke i bërë ballë në të njëjtën kohë sfidave të globalizmit. Adoptimi i monedhës së përbashkët nga vendet e reja anëtare duke filluar me Slloveninë më 1 Janar 2007, do të kontribuojë më tej në këtë drejtim. Gjithashtu, praktika tregon se çështje të tilla si reforma në sistemin gjyqësor, lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, duhen adresuar në një fazë të hershme të procesit të zgjerimit.

### *E ardhmja e procesit*

Procesi i zgjerimit do të udhëhiqet nga tri parime:

- *Konsolidimi* (konsolidimi i arritjeve të deritanishme dhe mbajtja e premtimeve të dhëna).
- *Kushtëzimi* (cdo hap i një vendi aspirant duhet shqyrtuar në përputhje me arritjen e standardeve të kërkuara nga procesi i aderimit).
- *Komunikimi* (procesi i zgjerimit duhet komunikuar me qytetarët dhe komunitetet e ndryshme në mënyrë që të gëzojë mbështetjen e qytetarëve dhe të forcojë legjitimitetin demokratik).

Në dallim nga antarësimi i Bullgarisë dhe Rumanisë, kësaj radhe BE-ja e ka bërë të qartë në Strategjinë e saj të Zgjerimit se, nuk do të përcaktojë një datë për asnjë nga vendet kandidatë deri në momentin që të përfundojë i gjithë procesi i negociimit të *acquis communautaire*.

Në këtë kuadër, procesi i negociimit pritet të jetë më rigoroz ku për cdo kapitull do të vendosen kushte për hapjen dhe mbylljen e tij. Ndërkohë që i gjithë procesi i negociimit do të vazhdojë të udhëhiqet nga parimi "*asgjë nuk është rënë dakord derisa për cdo gjë të jetë rënë dakord*". Në rast se vendi kandidat nuk ka përmbyllur detyrimet që rrjedhin nga negociimi, atëherë BE-ja ruan të drejtën e pezullimit të të gjithë negociat-

ave apo të një kapitulli specific. Këtë mjet, BE-ja ka filluar ta përdorë që në rastin e negociatave me Turqinë. Përsa i përket vendeve të Ballkanit Perëndimor të cilat ende nuk kanë fituar statusin e vendit kandidat, progresi do të matet mbi bazën e zbatimit konkret të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. Pra, prioriteti kryesor për Shqipërinë do të jetë zbatimi me korrektësi i të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja, si e vetmja mundësi për të përparuar në etapat e mëtejshme të procesit të integrimit europian. Viti 2007 do të jetë i rëndësishëm përse i përket objektivit që ka vendosur BE-ja për të nënshkruar marrëveshjet e lehtësimit të vizave me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në të njëjtën kohë të përfshirjes fillimisht të Kroacisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë në sistemin e kumulimit diagonal të rregullave të origjinës.

### *Kapaciteti i BE-së për të integruar anëtarë të rinj*

Këshilli Europian në takimin e tij të Qershorit 2006 i kërkoi Komisionit Europian të përgatiste një raport special në lidhje me kapacitetin e BE-së për të integruar anëtarë të rinj. Në të vërtetë, çështja e kapaciteteve absorbuese të BE-së është hedhur si tezë që në Këshillin Europian të Kopenhagenit në vitin 1993. Ndërkohë, me përfundimin e zgjerimit të pestë është konsoliduar një opinion, sipas të cilit, "*shpejtësia e procesit të zgjerimit duhet të marrë në konsideratë edhe kapacitetin integruar të vetë BE-së*".

Duke ritheksuar rëndësinë që paraqet perspektiva europiane për vendet e Ballkanit Perëndimor, Komisioni Europian përcakton se zgjerimi i ardhshëm mund të realizohet vetëm pasi BE-ja të ketë përfunduar një reformë institucionale. Kjo, përpos të tjerash edhe për faktin se Traktati i Nicës që është në fuqi ngurtëson një numër fiks vendesh anëtare të BE-së prej 27.

Sipas Komisionit Europian, në mënyrë që zgjerimi të vazhdojë të jetë një histori sukcesi, BE-ja duhet të sigurojë kapacitetin për t'i bërë ballë procesit të mëtejshëm të integrimit europian. Ndërkohë, vendet kandidatë duhet të përmbushin në mënyrë rigorozë dhe nën një monitorim të vazhdueshëm të gjitha detyrimet që burojnë prej antarësimit. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet funksionimi i një bashkimi i cili para së gjithash përcaktohet nga vlerat e përbashkëta të anëtarëve të tij.

## NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN NËNTOR 2006

(vijon nga faqja 1)

4. Projektligji: "Për Buxhetit e Shtetit 2007".
5. Projektligji: "Për ratifikimin e Protokollit nr.13, të Konventës Europiane, për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore, për heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat".
6. Projektligji: "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore"
7. Projektligji: "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për parandalimin e terrorizmit"
8. Projektligji: "Për Prokurimin Publik"

### *Ligji për Prokurimin publik*

Komisioni i Integritit, deri në keto momente të aktivitetit të tij ka shqyrtuar kryesisht marrëveshje ndërkombëtare të cilat janë miratuar në përgjithësi me unanimitet nga anëtarët e Komisionit.

Për çdo projektligj, janë kërkuar shpjegime të hollësishme nga specialistë të sektorëve që kanë marrë pjesë në negociatat për hartimin projektligjit apo si dhe nga ato institucione përgjegjëse të cilët do të merren me vënien në zbatim të ligjit pasi ai të ketë hyrë në fuqi sipas procedurave të parashikuara.

Projektligji për prokurimin publik, hartimi i të cilit është i bazuar në direktiven 2004/18/EC të BE-së, është një ndër hapat e qeverisë për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të europian.

Në bazë të traktatit themelues, neni 249 (ish 189) sipas të cilit " *direktiva e detyron shtetin anëtar të cilit i është drejtuar përpara i përket rezultatit që duhet arritur, duke lënë në kompetencë të organeve shtetërore zgjedhjen e formës dhe të mjeteve*" Këshilli i Ministrave, në bashkpunim me specialistë në fushën e përafrimit të legjislacionit, duke u mbështetur në karakterin e direktivës dhe në nevojat e mundësitë për përafrimin e legjislacionin ka propozuar me të drejtën, që i jep Kushtetuta për iniciativën ligjore, projektligjin e sipërpërmendur.

Duke iu referuar edhe relacionit të qeverisë, bashkëlidhur projektligjit, shihet qartë niveli i përputhshmërisë me direktivën në të cilën projektligji është mbështetur.

Projektligji mundëson rregullimin ligjor të procedurave të prokurimit publik në lidhje me punët, furnizimet, dhe shërbimet, në përputhje me *acquis communautaire*. Synimi i këtij projektligji është ulja e mundshmërisë për mashtrim dhe korrupsion.

Aktualisht shkalla e përputhshmërisë me legjislacionin komunitar, në fushën e prokurimit, siç është cilësuar edhe nga raporti i fundit i Komisionit Europian 2006 është e ulët. Duke i'u referuar edhe komenteve të BE-së në fushën e prokurimeve publike sipas të cilave vihet re një progres i limituar, (raporti i Komisionit Europian 2005 dhe 2006) ndërkohë që BE

kërkon një progres të dallueshëm, Komisioni për Integritimin Europian në vijim të punës së tij konsideron se prokurimet publike janë një nga prioritetet kryesore të Partneritetit Europian. Për pasojë Komisioni shpreh domosdoshmërinë dhe mirëpret rishikimin e legjislacionit ekzistues për të siguruar përafrimin e tij me direktivat e BE, më konkretisht me direktivën 2004/18/EC të Parlamentit Europian dhe zbatimin në praktikë të detyrimeve që rrjedhin nga MSA.

Projektligji synon të përcaktojë rregulla dhe procedura për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve. Projektligji është konsultuar me ekspertë ligjor të Bashkimit Europian.

Gjithashtu u vlerësuan të rejtat që ky projektligj do të sjell në krahasim me ligjin ekzistues të prokurimeve publike:

Në analizën e projektligjit vërehet krijimi i një institucioni të pavarur, Avokati i Prokurimeve, i cili do të shqyrtojë ankesat e ardhura nga subjektet për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik nga entet prokuruese. Sipas rekomandimeve të BE-së ankesat duhet të shqyrtohen nga një institucion i pavarur. Sa më shumë pavarësi të fitohet aq më mirë është në kuptim të direktivave. Pozitiv është fakti që ky institucion do të ketë detyrimin për raportim në Parlament, Qeveri dhe tek Presidenti (neni 17 pika 2).

Në vijim vlerësohet se projektligji parashikon detyrimin e APP-së për publikimin elektronik të dokumentacionit të tenderit përveç publikimit të tyre në Buletinin e Prokurimeve Publike, funksion ky i zbatuar kohët e fundit nga APP megjithëse jo detyrim ligjor. Kjo mënyrë publikimi e përshtatur me direktivat e BE-së sjell një rritje të transparencës së procedurave të prokurimit publik pasi subjektet që kërkojnë të marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik kanë më tepër burime për të marrë informacione për ato. Direktivat e BE-së (konkretisht nenet 35 dhe 36) parashikojnë gjithashtu edhe njoftim ndërkombëtar gjë e cila është e përealizueshme pasi kjo lidhet me hyrjen e Shqipërisë në BE.

Projektligji parashikon heqjen e prokurimit të drejtpërdrejtë dhe për pasojë të kompetencës vendimarrëse të Këshillit të Ministrave dhe APP-së në procedurat e prokurimit publik që zhvillojnë entet prokuruese, duke rritur përgjegjësinë e entit prokurues në këto procedura. Komisioni vlerëson se kjo gjë do të sjellë uljen e nivelit të korrupsionit duke përmbushur kështu kërkesën e vazhdueshme të BE-së lidhur me këtë problem.

(vijon në faqen 7)



## NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN NËNTOR 2006

(vijon nga faqja 6)

Në vazhdim, projektligji parashikon një shkurtim të afateve për ankim. Në shumë vende ky afat kohor luhet nga 5 deri në 10 ditë pune.

Përgatitja dhe hartimi i projektligjit "Për prokurimin publik" në përputhje me direktiven e BE-së është faza e parë e përafrimit të legjislacionit vendas të prokurimeve publike, siç është parashikuar në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit vendas me atë të BE-së dhe në MSA. Më konkretisht neni 70 i MSA-së, titulli VI i saj parashikon përafrimin e legjislacionit, imponimin e ligjeve dhe rregullave të konkurrencës duke parashikuar shprehimisht se: "...palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet. Gjatë fazës së parë të përcaktuar në Nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, përafrimi do të përqendrohet në elementët thelbësorë të *acquis* së Tregut të Brendshëm ashtu si dhe në fusha të tjera të rëndësishme si konkurrenca, të drejtat mbi pronësinë intelektuale, industriale dhe tregtare, prokurimi publik, standardet dhe certifikimi, shërbimet financiare, transporti detar dhe tokësor - duke i kushtuar rëndësi të veçantë sigurisë dhe standardeve mjedisore si dhe aspekteve sociale - ligji për kompanitë tregtare, kontabiliteti, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e të dhënave, shëndeti dhe siguria në punë dhe mundësi të barabarta. Gjatë fazës së dytë, Shqipëria përqendrohet në pjesët e mbetura të *acquis*".

Në përfundim të shqyrtimit të projektligjit rezulton se shkalla e përputhshmërisë së projektligjit me *acquis* communautaire nuk është tërësisht e plotë për vetë faktin se adoptimi dhe përafrimi me direktivën 2004/18/EC të BE-së është bërë deri në atë masë që të mund të jetë praktikisht i zbatueshëm në Shqipëri. Në disa raste kërkohet një kuadër ligjor paralel (rasti i përdorimit të mjeteve elektronike), në disa raste të tjera implementimi i direktives nuk është bërë për shkak të mungesës së kushteve ekonomike e sociale të duhura.

## Vlerësimi i pyetësorit mbi "Axhendën Europiane" në Parlamentet Kombëtare

(Ky pyetësor është përgatitur nga Senati i Republikës Çeke. Informacioni i dhënë nga Shtetet anëtare të BE-së përbën një burim referues lidhur me pozicionin dhe funksionin e Komisionit Parlamentar për Integrimin European)

Republika Çeke ashtu si edhe Parlamenti i jep rëndësi procesit të asociimit. Parlamenti i Republikës Çeke merr pjesë intensivisht në harmonizimin e ligjeve me ato Europiane. Senati ka dërguar këtë pyetësor që është përgatitur nga anëtarët e stafit të Zyrës së Senatit në nëntor 2001 në mënyrë që të marrë sa më shumë informacion dhe ta përdorë atë për të përgatitur Senatin dhe Zyrën e tij veçanërisht për rolin e ri që mund të luajë Parlamenti i Republikës Çeke mbas pranimin në Bashkimin European. Senati i Parlamentit të Republikës Çeke është në të njëjtën kohë gati të bashkohet në diskutimet mbi të ardhme BE-së. Senati ka zgjedhur delegatët e tij për të marrë pjesë në Konferencën mbi të Ardhmen e Europës. Organi i Senatit përgjegjës për shqyrtimin e punës së Konferencës dhe propozimin e vendimeve të Senatit në lidhje me çështjet më të rëndësishme të diskutuara nga Konferenca është Komisioni mbi Çështjet e Integritimit European. Axhenda e Komisionit në lidhje me IGC-të e ardhshme në 2004 duke përfshirë dhe takimet e Konferencës ekzekutohen nga Nënkomisionet mbi Konferencën Ndërqeveritare të BE-së në vitin 2004. Në përputhje me axhendën e tij, stafi i Komisionit është përforcuar me një këshilltar ekspert.

Forum i Kombëtar mbi të Ardhmen e BE-së parashikohet të punojë nën patronazhin e Senatit dhe qëllimi i tij do të jetë të përfshijë në diskutim përfaqëuesit e shoqërisë civile. Për më tepër, linket që lidhen me integrimin european do të shtohen në faqen elektronike të Senatit. Pyetësori është shpërndarë së bashku me një letër nga Sekretari i Përgjithshëm i Senatit. Pyetësori iu dërgua dhomave të parlamentit në këto vende: Belgjikë, Danimarkë, Finlandë, Francë, Irlandë, Itali, Luksenburg, Hungari, Zvicër, Hollandë, Poloni, Portugali, Austri, Rumani, Greqi, Sllovakia, Gjermani, Spanjë, Suedi, Turqi dhe Britani e Madhe. Shtatëmbëdhjetë dhoma iu përgjigjën këtij pyetësori, p.sh. përafërsisht 55% e numrit total të institucioneve të kontaktuara. Ky vlerësim mer në konsideratë vetëm pyetjet në pyetësor dhe informacionin e disponueshëm nga burime të tjera (p.sh. literaturë, internet)

*Pyetje nr. 1:*

*Sa anëtarë ka Komisioni i dhomës tuaj për Çështjet (ose Integrimin) European? Cila është struktura e tij (nënkomisionet, antarësia e pjestarëve të tij në komisione të tjera)? A janë angazhuar organe të tjera në çështjet europiane? A marin pjesë anëtarët e Parlamentit European të zgjedhur për vendin tuaj, në diskutimet e "axhendës Europiane" në dhomën tuaj parlamentare? Nëse po, si?*

*Austria:*

(vijon në faqen 8)

## Vlerësimi i pyetësorit mbi “Axhendën Europiane” në Parlamentet Kombëtare

(vijon nga faqja 7)

Në Nationalrat, Komisioni Kryesor merret me çështjet që lidhen me antarësinë në BE. Të njëjtin rol luan Komisioni i BE-së në Bundesrat. Komisioni Kryesor përbëhet nga 28 anëtarë të plotë që caktohen nga grupi politik mbi një bazë propocionale. Komisioni Kryesor mund të ngrejë një Nënkomision të Përhershëm të përbërë nga 14 anëtarë të plotë dhe 14 zëvendësues. Vetëm Komisioni Kryesor mund të vendosë që një projekt ose raport mbi çështjet e BE-së duhet të merret në konsideratë nga Nationalrat-i. Komisioni i BE-së së Bundesrat-it përbëhet nga 15 anëtarë dhe 15 zëvendësues që janë gjithashtu anëtarë në komisione të tjera. Anëtarët austriakë të Parlamentit Europian (PE) mund të marin pjesë në mbledhjet e të dyja dhomave por nuk mund të votojnë.

*Belgjika:*

Komisioni Këshillimor Federal mbi Çështjet Europiane ka 30 anëtarë (10 anëtarë të Dhomës së Përfaqësuesve, 10 anëtarë të Senatit dhe 10 anëtarë të Parlamentit Europian të cilët janë zgjedhur në Belgjikë). Komisioni nuk është ndarë në nënkomisione. 10 anëtarët e Parlamentit Europian janë anëtarë me kohë të plotë; ata mund të marin pjesë në diskutimet dhe në procedurat e votimit të Komisionit Këshillimor ashtu si anëtarët e parlamentit kombëtar. Ata nuk kanë një të drejtë për pjesëmarrje në sesionet plenare të Senatit. (Edhe pse në dy raste përjashtuese anëtari i Parlamentit Europian që ka qenë një bashkë-raportues për komisionin këshillimor i ishte dhënë mundësia të drejtojë sesionin plenar). Komisioni Këshillimor Federal nuk ka një kompetencë ekskluzive për të trajtuar çështjet Europiane. Të gjithë komisionet e tjera përfshihen në Çështjet Europiane kur ka një lidhje me kompetencat e tyre.

*Finlanda:*

Komisioni i Madh aprovon, në mbështetje të Parlamentit, pozicionin e parlamentit mbi të gjithë aktet Europiane të propozuara që janë vendosur nga Këshilli i BE-së dhe përmbajnë parashikime që mund të kenë kërkuar një akt të parlamentit nëse Finlanda nuk do të ishte anëtare e BE-së. Para aprovimit të tij, ai konsultohet me raporte të komisioneve sipas departamenteve përkatëse. Propozimet që lidhen me shtyllën e dytë janë në kompetencë të Komisionit për Çështjet e Jashtme. Komisioni i Madh ka 25 anëtarë dhe 13 zëvendësues të kualifikuar të cilët janë në të njëjtën kohë anëtarë të komisioneve të tjera (kryesisht kryetarë të komisioneve dhe seksioneve të tjera). Kryetarët, dy nënkryetarët dhe një deputet i çdo seksioni organizojnë aktivitetet e rregullta të Komisionit. Mementalisht, ka dy nënkomisione: nënkomisioni i WTO-së dhe nënkomisioni mbi shtyllën e tretë; derisa së fundi ishte gjithashtu Komisioni i pikpamjeve të Finlandezëve mbi të ardhmen e Europës.

*Franca:*

*Senati:* Delegacioni për BE-në është një komision i përbashkët i përbërë nga 36 anëtarë të Parlamentit Europian; anëtarët e Parlamentit Europian mund të marin pjesë në aktivitetet e tij si këshilltarë.

*Asambleja Kombëtare:* Delegacioni është një komision i përbashkët që përbëhet nga 36 anëtarë; anëtarë të Parlamentit Europian janë të ftuar të marin pjesë në sesionet e tij. Komisionet e departamenteve respektive supervizojnë veprimtaritë e Qeverisë që i përkasin axhendës Europiane dhe mund t'u kërkohej të plotësojnë qëndrimet e tyre mbi propozimet e akteve europiane.

*Gjermania:*

*Bundesrati:* Komisioni i Çështjeve Europiane përbëhet nga 16 anëtarë. Mbledhjet organizohen kryesisht nga nënpunsi civil të qeverive lokale, ministrat marin pjesë në mbledhje vetëm në rastet e çështjeve politike sensitive. Kryetari i Komisionit propozohet nga anëtarët e Komisionit dhe më pas zgjidhet nga sesioni plenar i Bundesrat-it. Disa anëtarë të komisionit i përkasin disa komisioneve të tjera të përhershme, nuk ka nënkomisione. Komisioneve të tjera të specializuara u kërkohej opinioni për dokumentacionin brenda juridiksionit të tyre. Anëtarët e Parlamentit Europian nuk marin pjesë në diskutimet e komisioneve.

*Britania e Madhe:*

*Dhoma e Komunëve:* Komisioni Europian i Inspektimit ka 16 anëtarë, disa nga të cilët janë gjithashtu aktivë në komisionet e përhershme sipas departamenteve; Komisioni nuk cakton nënkomisione. Komisionet e përhershme sipas departamenteve, veçanërisht Komisioni për Çështjet e Jashtme shqyrton në disa raste disa çështje mbi BE-në (shtylla e dytë). Anëtarët e Parlamentit nuk marin pjesë në ndonjë sesion formal të Dhomës së Komunëve.

*Dhoma e Lordëve:* Komisioni i Bashkimit Europian ka 19 anëtarë dhe vepron nëpërmjet gjashtë nënkomisioneve (çështjet ekonomike dhe financiare, mardhëniet e jashtme dhe tragtare, energjitika, industria dhe transporti, politikat e përbashkëta të jashtme dhe të sigurisë; ambienti, bujqësia, kujdesi shëndetësor dhe mbrojtja e konsumatorit; ligji dhe institucionet; çështjet sociale; çështjet e edukimit dhe familjes); nënkomisionet e tjera mund të jenë të përkohshme (ad hoc). Vetë dhoma, megjithatë, debaton shpesh probleme, mocione dhe legjislacionin mbi çështjet europiane. Anëtarët e Parlamentit Europian nuk mund të marin pjesë në punime por është mëse e zakonshme për ata që të japin evidenca për Komisionin e BE-së.

*Greqia:*

Komisioni mbi Çështjet Europiane ka 31 anëtarë që mund të jenë në të njëjtën kohë anëtarë të komisioneve të tjera. Sesionet e tij mund të mbahen nga përfaqësuesit e Parlamentit Europian të cilët mund të paraqesin raportet, propozimet e tyre. Komisionet e tjera mund të diskutojnë “propozimet Europiane” brenda qëllimit të autoritetit të tyre respektiv.

*Hungaria:*

Komisioni mbi Çështjet e Integritimit Europian ka 26 anëtarë dhe nuk ndahet në nënkomisione. Shumë nga anëtarët janë krytarë të nënkomisioneve të integritimit.

(vijon në faqen 9)



## Vlerësimi i pyetësorit mbi "Axehtëndën Europiane" në Parlamentet Kombëtare

(vijon nga faqja 8)

Komisioni European ushtron kontroll parlamentar mbi Qeverisjen në çështjet e integritimit. Komisioni ndjek të gjitha aspektet e procesit të zgjerimit dhe dhe përgatitjes së Hungarisë për antarësimin në BE. Komisioni është i ngarkuar të dëgjojë ministrat dhe ambasadorët para se t'i emërojë ata dhe vepron si pala hungareze e JPC-së.

*Luksemburg:*

Komisioni mbi Çështjet e Jashtme dhe Europiane dhe i Mbrojtjes është një komision i përbashkët i përbërë nga 11 anëtarë; nuk është i ndarë në nënkomisione. Para dhe pas mbledhjes së Këshillit European Komisioni merr raportet nga Ministri i Çështjeve të Jashtme. Disa çështje (përfshirë dhe propozimet e direktivave) iu referohen komisioneve të tjera përkatëse sipas departamenteve. Anëtarët e Parlamentit European ftohen gjithashtu të marani pjesë në të gjithë sesionet e komisionit që kanë të bëjnë me axhendën Europiane.

*Hollanda: Dhoma e Përfaqësuesve:*

Komisioni mbi Çështjet e Jashtme ka 25 anëtarë dhe është përgjegjës për informimin mbi koordinimin dhe nisjen e diskutimeve mbi çështjet europiane në sesionin plenar. Komisioni mblidhet njëherë në dy javë, diskuton informacionin e dhënë nga ministrat respektivë në takimet e Këshillit të BE-së, propozimet legjislative të paraqitura nga Komisioni etj. Seancat e mëdha dëgjimore ose sesionet plenare mbahen me rastin e samitit të Këshillit të BE-së.

*Polonia:*

*Sejm-i (Dhoma më e Ulët):* Komisioni European është më i madhi në këtë Dhomë. Ai përbëhet nga 46 Përfaqësues, që përbëjnë 10% të të gjithë numrit të Përfaqësuesve. Komisioni ka ngritur një nënkomision që është për të supervizuar përdorimin e fondeve suplementare nga BE-ja.

*Portugalia:*

Komisioni mbi Çështjet Europiane është një komision i përbërë në mënyrë proporcionale, ka 26 anëtarë dhe përbëhet nga 2 nënkomisione: Nënkomisioni i Bashkimit Monetar dhe Ekonomik dhe Nënkomisioni mbi Unitetin Ekonomik dhe Social (secili i përbërë nga 8 anëtarë). Përfaqësuesit e Parlamentit European ftohen të marini pjesë në çdo sesion të Komisionit European dhe në ato sesione të komisioneve të tjera që kanë të bëjnë me, për shembull, Axhendën e vitit 2000, të ardhmen e BE-së, etj.

*Slovakia:*

Komisioni mbi Integritimin European përbëhet nga 19 anëtarë të cilët janë njëkohësisht anëtarë të komisioneve të tjera.

*Spanja:* Parlamenti ka një Komision të bashkuar mbi Çështjet Europiane që përbëhet nga 33 përfaqësues dhe 21 senatorë. Aktualisht, ka dy nënkomisione (secili i përbërë nga 14 anëtarë) njëri i ngarkuar me procesin e zgjerimit të BE-së dhe tjetri punon mbi përgatitjen për Konferencën Ndërqeveritare për vitin 2004. Komisionet e tjera, duke iu referuar kompetencave të tyre të veçanta, diskutojnë çështjet europiane. Anëtarët e Parlamentit European nuk ftohen të marini pjesë në mbledhjet e këtyre komisioneve.

*Suedia:*

Qeveria informon vazhdimisht Parlamentin mbi zhvillimet brenda kuadrit të bashkëpunimit të BE-së dhe mbi qëndrimin e tij mbi propozime të rëndësishme. Çështjet europiane diskutohen gjithashtu në sesionin plenar (debatohet mbi rezultatet e samitit të Këshillit të BE-së), komisionet e veçanta (propozimet e komisionit dhe memorandumit qeveritar që i lidhen me kompetencën e tyre respektiv, negociatat me ministrant para dhe pas mbledhjeve të Këshillit të BE-së, supervizimi i transpozicionit) dhe Bordin Këshillimor mbi Çështjet e BE-së. Bordi Këshillimor është një organ i përbashkët dhe përbëhet nga 17 anëtarë dhe 30 anëtarë zëvendësues. Ai mblidhet një herë në javë për të diskutuar qëndrimin e Qeverisë para mbledhjes së Këshillit të BE-së. Kontaktet me anëtarët e Parlamentit European mbahen brenda partive politike dhe Anëtarët e Parlamentit European (APE) janë gjithashtu të ftuar të marini pjesë në seancat dëgjimore të organizuara nga Parlamenti.

*Pyetja nr. 2:*

*Nëse vendi juaj ka një parlament dydhomësh, a bashkëpunojnë komisionet "Europiane" të të dyja dhomave, apo ka ndonjë komision të bashkuar?*

Parlamentet dydhomëshe ekzistojnë në Belgjikë, Francë, Hollandë, Poloni, Spanjë dhe Britani e Madhe. Komisionet e bashkuara veprojnë në Belgjikë dhe Spanjë. Në vendet e tjera komisionet punojnë në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri edhe pse në Francë dhe Britani të Madhe ekziston një lloj diferencimi indirekt i punës ndërmjet tyre. Në Britaninë e Madhe, për shembull, Komisioni i Komunëve shqyrton të gjithë dokumentet e BE-së, por jo në shumë detaje, ndërkohë që Komisioni i Lordëve zgjedh një numër të vogël dokumentesh për një shqyrtim më të detajuar, anëtarët e stafit të të dy komisioneve bashkëpunojnë ndërmjet tyre. Në Austri, anëtarët e komisionit bashkëpunojnë në bazë të grupeve parlamentare; anëtarët e stafit të të ashtuquajturve "Klube" janë përgjegjës për informimin e anëtarëve të tyre në të dyja dhomat. Në Gjermani, të dy komisionet shkëmbejnë vazhdimisht pikpamje dhe informacion, kohë pas kohe ata mblidhen sëbashku nëse ka nisma të rëndësishme për nga pikpamja politike, ndonjëherë ata organizojnë aktivitete të përbashkëta, siç janë seancat dëgjimore etj.

*Pyetja nr. 3:*

*A merit komisioni fillimisht me transpozimin e akteve normative të BE-së brenda legjislacionit vendas apo ka detyra të ndryshme (në rastin e vendeve kandidate p.sh. të kontrollojë procesin e negociimit, në rastin e vendeve anëtare të diskutojë propozimet e akteve normative të organeve të BE-së, të kontrollojë qëndrimin e qeverisë në Këshillin e BE-së etj.)? Sa shpesh mblidhet komisioni? A vendos komisioni vetë apo përgatit vendimet për seancën plenare? Si e garantoni ju njohjen e çështjeve Europiane për anëtarët e tjerë të dhomës tuaj?*

(vijon në faqen 10)

## Vlerësimi i pyetësorit mbi “Axeëndën Europiane” në Parlamentet Kombëtare

(vijon nga faqja 9)

### *Austria:*

Komisioni Kryesor mblidhet zakonisht një ose dy herë në muaj, por çështjet; që lidhen me BE-në trajtohen rreth katër deri në gjashtë herë në vit. Nënkomisioni i Përhershëm i Nationalrat-it mblidhet gjithashtu katër deri në gjashtë herë në vit. Komisioni i BE-së i Bundesrat-it mblidhet vetëm me kërkesë, që bëhet rreth tre deri në pesë herë në vit. Qeveria Federale informon Nationalrat-in dhe Bundesrat-in mbi të gjitha projektet e BE-së dhe i fton ata të mbajnë një qëndrim ndaj tyre. Qëndrimet e Nationalrat-it janë të detyrueshme kur projekti i BE-së duhet të transformohet në legjislacionin vendas; shmangia nga një qëndrim i tillë është e lejueshme vetëm për arsye të imponimit të politikave të huaja ose politikave të integritit. Një qëndrim i adoptuar nga Bundesrat-i është i detyrueshëm në të gjitha rastet, në të cilat projekti në mënyrë të nevojshme duhet të transformohet brenda legjislacionit vendas nga një Akt Federal Kushtetues i cili mund të kërkojë miratimin e Bundesrat-it.

### *Belgjika:*

Transpozimi i akteve normative Europiane i përket kompetencës së komisioneve respektive. Komisioni Këshillimor koordinon kryesisht mbikqyrjen parlamentare të procesit të vendim-marrjes europiane; kontrollat dhe zbatimin e masave të adoptuara parlamentare mbi çështjet europiane. Ai jep gjithashtu opinione mbi procesin e rishikimit të marrëveshjeve themeluese. Ai organizon seanca dëgjimore të Qeverisë para dhe pas mbledhjeve të Këshillit të BE-së. Ai informon komisionet e tjera mbi propozimet e rëndësishme legjislative të Komisionit, mbi programin legjislativ të BE-së, librat jeshilë dhe të bardhë, axhendën e Këshillit Ministror etj.; analizon gjithashtu raportet vjetore Qeveritare mbi zbatimin e marrëveshjeve themeluese etj. Komisioni i përbashkët mblidhet tre herë në vit; konkluzionet e takimeve paraqiten në sesionet plenare të të dyja dhomave.

### *Finlanda:*

Transpozimi është në kompetencë të komisioneve të veçanta. Komisioni i madh fokusohet në formulimin e qëndrimit të tij mbi propozimet e akteve normative Europiane dhe mbi seancat e hapura ministeriale të organizuara para mbledhjeve të rregullta të këshillit të BE-së që konfirmon qëndrimin e negociimeve qeveritare. Komisioni i Madh mblidhet dy herë në javë. Dy Komisionet e caktuara marrin vendime në mbështetje të Parlamentit; sesionet plenare mund të diskutojnë çështje, megjithatë, ato nuk mund të marrin vendime.

### *Franca:*

*Senati:* Transpozimi është në kompetencë të komisioneve sipas departamenteve; komisioni shqyrton propozimet e akteve dhe direktivave Europiane dhe monitoron veprimtarinë e BE-së. Komisioni mblidhet një herë në javë në kohën e sesioneve parlamentare. Ai mer vetë vendime ose inicion vendime të komisioneve sipas departamenteve ose ato të Senatit.

*Asambleja Kombëtare:* Transpozimi është në kompetencë të komisioneve sipas departamenteve. Komisioni i BE-së mblidhet një herë në javë; meret me propozimet e akteve legjislative Europiane dhe me dokumenta të shkruara të mara nga Qeveria; organizon seanca të hapura ministeriale dhe seanca të hapura të ekspertëve, etj. Nëse një kusht parlamentar është kaluar, Qeveria është e detyruar të mos votojë për propozimin e shqyrtuar në Këshillin e BE-së derisa shqyrtimi të ketë përfunduar. Qeveria çdo vit e pajis komisionin me 2.000–2.500 dokumente që janë përzgjedhur nga kryetari i komisionit dhe sekretari i tij kështu që përafërsisht 1.200 dokumente janë shqyrtuar në mënyrë të detajuar.

### *Gjermania:*

*Bundesrat:* Komisioni reflekton mbi projekt qëndrimet e BE-së që ndikojnë në pushtetin legjislativ të Laender-it dhe sugjeron rekomandime për komentet e punimeve plenare. Në senacën plenare mund të adoptohet një rezolutë ose të bëhen amendime. Qeveria Federale është e detyruar të marrë parasysh rezolutën para vendosjes së pozicionit negociues; aty ku një iniciativë e tillë ndikon pushtetin legjislativ të Laender-it, vendosja e autoritetit të tyre ose procedurave të tyre administrative, opinioni i Bundesrat-it është i detyrueshëm. Komisioni mblidhet çdo tre javë. Sekretariati i komisionit sheh dokumentet dhe vendos çfarë dokumentesh duhet të reflektojë dhe i kalon ato tek Laender-i.

### *Britania e Madhe:*

*Dhoma e Komunëve:* Komisioni i specializuar meret me propozimet e akteve legjislative të BE-së dhe me dokumente të tjera si edhe me aktivitetin e ministrave në Këshillin e BE-së; megjithatë, nuk është aktiv në procesin e transpozimit. Komisioni mblidhet një herë në javë. Ai mbledh informacion mbi impaktin e mundshëm ligjor dhe politik të propozimeve të diskutuara dhe rekomandon cilat dokumenta duhet të shqyrtohen në detaje.

*Dhoma e Lordëve:* Komisioni i BE-së vlerëson të gjithë procesin e integritit dhe të gjithë dokumentet legjislative Europiane që vijnë nga procesi i aksesit i paraqiten atij për shqyrtim (të tre shtyllat – 1000 dokumenta në vit). Pas çdo Këshilli European Komisioni dëgjon raportimet nga Ministri për Europën. Komisioni i Përhershëm i BE-së mblidhet zakonisht çdo dy javë dhe Nënkomisionet mblidhen zakonisht çdo javë; të gjithë subjektet përkatëse meren parasysh. Nëse Komisioni fillon të diskutojë një propozim, qeveria nuk mund të votojë për të në Këshillin European deri sa diskutimi të ketë mbaruar. Kur puna e Komisionit çon në një raport të mirfilltë (rreth 25% e dokumenteve) ky do të botohet dhe do të bëhet i disponueshëm (rreth 50% e tyre) për diskutim në Dhomë. Qeveria është e detyruar të marrë një qëndrim në raportin e Komisionit brenda dy muajve.

### *Greqia:*

Komisioni European adopton rekomandimet mbi aktet europiane legjislative dhe mbi qëndrimet këshilluese për

(vijon në faqen 11)

## Vlerësimi i pyetësorit mbi “Axhendën Europiane” në Parlamentet Kombëtare

(vijon nga faqja 10)

çështjet institucionale të BE-së dhe ia paraqet ato Parlamentit dhe Qeverisë. Komisioni mblidhet dy herë në muaj.

*Hungaria:*

Komisioni European fokusohet në kontrollin e Qeverisë nga njëra anë, dhe të revizionit të procesit të përafrimit të legjislacionit nga ana tjetër. Komisioni mblidhet një herë në tre javë dhe gjithashtu çdo muaj bën mbledhje të zgjeruara të mbajtuara nga kryetari i nënkomisionit të integritetit dhe nga i të gjithë nënkomisionet European, në të cilën ministri i punëve të jashtme informon rreth ecurisë së negociimeve.

*Luksemburgu:*

Komisioni mbi Çështjet Europiane të Jashtme dhe të Mbrojtjes meret kryesisht me çështjet institucionale (aktualisht, për shembull, me të ardhmen e Europës dhe rolin e parlamenteve kombëtare në Europë), dhe gjithashtu edhe me transpozimin Komisioni është duke diskutuar mënyrat efektive të revizionit parlamentar të propozimeve të akteve dhe direktivave europiane. Komisioni përgatit vendimet për seancë plenare.

*Hollanda:*

*Dhoma e Përfaqësuesve:* Komisioni European fokusohet në shqyrtimin e propozimeve të akteve normative europiane dhe qëndrimet e mara nga departamentet individuale. Këshilluesit e Komisionit elaborojnë raporte të tjera që vlerësojnë impaktin e propozimeve sipas legjislacionit dhe politikës kombëtare. Transpozimi i propozimeve të adoptuara është në kompetencë të komisioneve sipas departamenteve. Gjithashtu, Komisioni i kushton vëmendje të veçantë amendamenteve në marrveshjet themeluese dhe ratifikimit të tyre.

*Polonia:*

*Sejm (Dhoma më e Ulët):* Komisioni European me tu krijuar; është ngarkuar me detyrat e Komisionit mbi Çështjet e Integritetit European dhe Komisionit mbi Legjislacionin European, p.sh. supervizimin e procesit të negociimit si edhe supervizimin e transpozimit të legjislacionit European – nëse një propozim i veçantë i referohet Komisionit. Ai mblidhet një herë në javë. Të gjithë përfaqësuesit mund të konsultohen me të gjithë dokumentacionet e duhura të qeverisë të disponueshme nga Presidenti i Sejm-it.

*Portugalia:*

Aktet Europiane traspozohen nga komisioni në formën e ligjeve ose dekretive që kanë kaluar nga Qeveria, ose në formën e masave të tjera të mara nga Qeveria; Komisioni European nuk luan ndonjë rol në këtë proces. Komisionet sipas departamenteve shqyrtojnë propozimet e akteve dhe madje mund të propozojnë amendime të dekret-ligjeve që – meqë amendamentet janë adoptuar- bëhen ligje. Parlamenti përqendrohet më shumë në përgatitjen e propozimeve të akteve normative Europiane sesa në transpozimin e tyre – Komisioni European ai që është i ngarkuar me rishikimin paraprak të akteve. Komisioni shqyrton modelet Europiane, zhvillon raportet për Qeverisjen (këto gjithashtu

mbështeten, përveç gjerave të tjera, në pozicionin e marë nga komisionet sipas departamenteve) dhe propozimet e rezolutave për seancën plenare. Supervizimi i Qeverisë përbëhet nga debatet e rregullta që kanë të bëjnë me raportet mbi integrimin european, seancat e hapura mbi takimet e Këshillit të BE-së, diskutimet mbi propozimet e akteve legjislative dhe diskutimet mbi kontributet financiare për BE-në. Komisioni mblidhet të paktën një herë në javë; anëtarët përkatës të komisioneve sipas departamenteve janë të ftuar të marrin pjesë në këto punime ose të paktën kërkohet opinioni i tyre.

*Slovakia:*

Komisioni mbi Çështjet e Integritetit European kontrollon zbatimin e Marrëveshjes së Asocimit, procesin e negociimit dhe të përafrimit të legjislacionit, përdorimin e fondeve suplementare të planifikuara për vendet kandidatë të BE-së; mblidhet një herë në muaj.

*Spanja:*

Komisioni i përbashkët diskuton propozimet e akteve normative europiane dhe adopton rezolutat për të udhëzuar veprimet e Qeverisë në çështjet e BE-së; mblidhet përafërsisht një herë në dy tre javë. Komisioni merr vetë vendime ose paraqet çështje të veçanta mbi të cilat mund të merren vendime në seancë plenare.

*Pyetja nr. 4:*

*Si e pajisni komisionin me bazë administrativ dhe profesionale? Sa anëtarë të stafit punojnë për komisionin? A bashkëpunon komisioni me organe të tjera të kancelarisë parlamentare, psh. Departamenti legjislativ, departamenti i veçantë mbi çështjet europiane, departamenti i mardhënieve ndërkombëtare etj?*

*Austria:*

Komisioni ka 14 anëtarë stafi përgjegjës për të gjitha çështjet e Bundesrat-it.

*Belgjika:*

Sekretariati i Komisionit të përbashkët përbëhet nga nënpunës të deleguar nga të dyja dhomat. Senati delegon dy sekretarë dhe një asistent sekretar i cili i përket Departamentit të Mardhënieve të Jashtme të Senatit.

*Finlanda:*

Komisioni i Madh punëson tre këshilltarë ligjorë, tre asistentë administrativë, një asistent, një ndihmës, një nënpunës për studimet kërkimore dhe një nënpunës për informimin publik. Një këshilltar dhe një asistent janë të vendosur në Bruksel. Sekretariati i Komisionit të Madh dhe ai i Komisionit për Çështjet e Jashtme formojnë Sekretariatit e BE-së që meret me marrëdhëniet me institucionet e BE-së në çështjet e BE-së dhe marrëdhëniet me parlamentet kombëtare. Sekretariati i BE-së shfrytëzon burimet administrative të tjera.

*Franca:*

*Senati:* Sekretariati i komisionit është Departamenti për Çështjet Europiane që gjithashtu kujdeset për aktivitetet e komisioneve ndërparlamentare dhe elaboron vëzhgime

(vijon në faqen 12)



## Vlerësimi i pyetësorit mbi "Axhendën Europiane" në Parlamentet Kombëtare

(vijon nga faqja 11)

krahasuese të sistemeve legjislativë. Sekretariati përbëhet nga 6 nënpunës që punojnë mbi baza të qëndrueshme (një nga këta në Bruksel) dhe dy nënpunës emerëohen për një periudhë më të shkurtër.

**Asambleja Kombëtare:** Komisioni i BE-së ka 25 punonjës: Drejtorin e sekretariatit, njëmbëdhjetë këshilltarë të specializuar në fusha individuale, shtatë nëpunës administrativë, katër asistentë dhe dy ndihmës. Sekretariati formon një pjesë të Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Çështjet Europiane; ai kryesisht bashkëpunon me Departamentin e Legjislacionit.

**Gjermania:**

**Bundesrat-i:** Është ngritur një sekretariat për Komisionet mbi Çështjet e Jashtme, Mbrojtjen dhe Çështjet Europiane. Ai harton axhendën për mbledhjet, mbledh dhe shpërndan dokumentat dhe përgatit rekomandimet për deklarimin e opinionit. Ai ka 15 anëtarë stafi.

**Britania e Madhe:**

**Shtëpia e Komunëve:** Komisioni ka pesëmbëdhjetë anëtarë të stafit, nga të cilët tre janë anëtarë të komisione të tjera: këto përfshijnë katër këshilltarë me ekspertizë në fusha të veçanta, dy këshillues ligjorë, dy nëpunës administrativë etj. Çdo departament qeveritar cakton një koordinator për të bashkëpunuar me Komisionin.

**Dhoma e Lordëve:** Komisioni ka aktualisht 16 anëtarë stafi, duke përfshirë Këshilltarët Ligjorë, Nënpunësit dhe Asistentët. Tre poste të tjera, së pari Asistentët Kërkues, duhen plotësuar për një kohë të shkurtër. Komisioni dhe Nënkomisionet punësojnë gjithashtu Specialistë Këshillues mbi baza ad-hoc. Nënpunësit dhe pjesa tjetër e stafit punojnë ngushtë me partnerët e tyre në Qeveri, kryesisht Zyra e Komonuelthit (Commonwealth) dhe e Çështjeve të Jashtme, kontaktojnë me Ministrinë për të kërkuar sqarime mbi çështje që ngrihen nga një propozim legjislativ Europian i veçantë dhe marrin një memorandum Shpjegimi nga departamenti përkatës i qeverisë për çdo propozim legjislativ.

**Greqia:**

Sekretariati është i përbërë nga katër nënpunës nga Departamenti i Çështjeve Europiane, të cilët bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin Legjislativ dhe me ekspertë të tjerë që bashkëpunojnë me Parlamentin.

**Hungaria:**

Sekretariati i komisionit Europian përbëhet nga tre këshilltarë, dy punonjës administrativë dhe disa të trajnuar (studentë). Në fushën e çështjeve ndërkombëtare, sekretariati bashkëpunon me Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

**Luksemburgu:**

Sekretariati i Komisionit, p.sh. një sekretare dhe asistentja e saj, kryen vetëm detyra të natyrës administrative, në aktivitete të tjera sekretariati bashkëpunon me Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Për shkak të axhendës së re në procesin

e vendimarrjes Europiane, sekretariati duhet të zgjerohet.

**Hollanda:**

**Dhoma e Përfaqësuesve:** Komisioni Europian ka një sekretar dhe dy këshilltarë për kontaktin me departamentet individuale. Këshilltarët bashkëpunojnë me këshilluesit nga komisionet e tjera dhe me Departamentin e Legjislacionit (përgatitjen e amendamenteve të propozimeve të akteve normative europiane). Organet respektive sipas departamenteve diskutojnë gjithashtu axhendën europiane.

**Polonia:**

**Sejm (Dhoma më e Ulët):** Departamenti i BE-së punon gjithashtu si sekretariati i Komisionit Europian (drejtori i tij është njëkohësisht dhe sekretari i Komisionit) dhe siguron baza organizative dhe të specializuara për marrëdhëniet me BE-në (Komisioni i Hyrjes, Konferenca e Kryetarit Parlamentar etj). Departamenti përbëhet nga nëntë nënpunës. Gjithashtu axhenda në diskutim shqyrtohen edhe nga Departamenti i Legjislacionit Europian (që përbëhet nga gjashtë juristë) i Departamentit të Kërkimit që përgatit qëndrimet ligjore. Departamenti i Kërkimit (ekuivalent me Institutin Parlamentar) është i ngarkuar me përkthimin dhe ekspertizën. Departamenti i Legjislacionit mer pjesë në diskutimin e propozimeve të akteve.

**Portugalia:**

Komisioni Europian përbëhet nga sekretari dhe dy këshilltarë; përdor ekspertizë të zhvilluar në bibliotekën parlamentare dhe bashkëpunon gjithashtu me Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

**Slovakia:**

Sekretariati i Komisionit përbëhet nga sekretari dhe një asistent i sekretarit. Komisioni bashkëpunon ngushtë me Institutin Parlamentar, veçanërisht me Departamentin e Legjislacionit dhe Përafrimit të Ligjeve, Departamentin e Analizave dhe Arsimit, Bibliotekë Parlamentare si edhe Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Protokollin.

**Spanja:**

Komisioni i përbashkët ka dy këshilltarë ligjorë dhe tre nënpunës administrativë që bashkëpunojnë me Departamentin e Studimeve Europiane, Departamentin e Studimeve dhe Dokumentacionin, Bibliotekën, Departamentin e Mardhënieve Ndërkombëtare, Protokollin, etj.

**Suedia:**

Sekretariati i Komisionit përbëhet nga tetë punonjës: Drejtori, tre sekretaret, administratori, katër asistentët dhe një nënpunës për informimin e publikut.

*Paraqitur nga z. Pavel Pelant Sekretar i Përgjithshëm i Senatit të Parlamentit të Republikës Çeke*

*Përktheu: Denada Breshanaj  
Qendra e Studimeve Parlamentare*

## Projektligji “Për Koncesionet”

PROJEKTLIGJ  
“PËR KONCESIONET”

### Kreu I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1

###### Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin e favorshëm, për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të projekteve koncesionare, të financuara nga sektori privat, duke rritur transparencën, barazinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë dhe duke mënjeluar kufizimet e panevojshme, për pjesëmarrjen e sektorit privat në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike.

Ky ligj synon zhvillimin e mëtejshëm të parimeve të përgjithshme të transparencës, efikasitetit dhe barazisë në lidhjen e kontratave nga autoritetet publike, nëpërmjet përcaktimit të procedurave të veçanta, për dhënien e projekteve koncesionare.

##### Neni 2

###### Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji me termat e mëposhtme nënkuptohet:

1. **“Ofertuesi” ose “Ofertuesit”**, janë subjekte juridike ose edhe bashkime të tyre, që kanë për qëllim të marrin pjesë apo që marrin pjesë në një procedurë përzgjedhjeje, në lidhje me një koncesion.
2. **“Procedura konkurruese e përzgjedhjes”**, është procedura për përzgjedhjen e koncesionarit, në përputhje me nenet 10 deri 21, të këtij ligji.
3. **“Koncesion”**, është marrëveshja pavarësisht nga emri që i jepet, ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit, ku përcaktohen kërkesat dhe kushtet e saj dhe në kuptimin e së cilës koncesionari:
  - a) realizon një veprimtari ekonomike, që, në të kundërt, do të kryhej nga autoriteti kontraktues, për një projekt koncesioni, kontratë administrimi apo shërbime të tjera publike;
  - b) merr përsipër të gjitha ose një pjesë thelbësore të rrezikut të lidhur me këtë veprimtari ekonomike;
  - c) merr një përfitim nëpërmjet:
    - i) pagesave të drejtpërdrejta nga autoriteti kontraktues apo për llogari të këtij të fundit;
    - ii) tarifave ose pagesave, që mblidhen nga përdoruesit a blerësit;
    - iii) një ndërthurjeje të këtyre tarifave dhe pagesave të drejtpërdrejta.
4. **“Koncesionari”**, është personi juridik, shqiptar ose i huaj, me ose pa pjesëmarrje, vendase apo të huaj, që lidh një kontratë koncesioni me një autoritet kontraktues.
5. **“Regjistër koncesioni”**, është regjistri i mbajtjes të së dhënave për procedurën e përzgjedhjes dhe të dhënies së koncesionit, që mbahet nga autoriteti kontraktues dhe që, në fund të procedurës, depozitohet në Agjencinë e

Prokurimit Publik. Forma dhe mënyrat e mbajtjes përcaktohen nga kjo agjenci.

6. **“Autoritet kontraktues”**, është autoriteti publik, që ka përgjegjësinë të lidhë kontratë koncesioni.

7. **“Mjete infrastrukurore”**, janë sistemet dhe asetet fizike, që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kryejnë shërbime publike.

8. **“Projekt koncesioni”**, është secila nga veprimtaritë e mëposhtme apo çdo ndërthurje e tyre, si: projektimi, ndërtimi, zhvillimi i mjeteve të reja të infrastrukturës, rehabilitimi, modernizimi apo zgjerimi i mjeteve të infrastrukturës ekzistuese; administrimi, zgjerimi apo shërbime të tjera, që lidhen me mjetet, e reja apo ekzistuese, të infrastrukturës.

9. **“Licencë”**, është një akt administrativ, që lëshohet nga autoriteti përkatës publik, për të ushtruar një veprimtari, bazuar në kritere objektive të kualifikimit.

10. **“Koncesione vendore”**, janë koncesionet për ato veprimtari ekonomike, që, në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, janë kompetencë e njësive të qeverisjes vendore.

11. **“Koncesione shtetërore”**, janë koncesionet për ato veprimtari ekonomike, që në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, janë kompetencë e njësive të qeverisjes qendrore.

12. **“Propozim i pakërkuar”**, është propozimi për të marrë përsipër projekte koncesioni, i cili nuk ka ardhur në përgjigje të një kërkesë të bërë nga autoriteti kontraktues, brenda kontekstit të një procedure përzgjedhëse konkurruese.

13. **“Investim privat”**, është propozimi, i financuar dhe i realizuar, tërësisht, nga sektori privat, ku sektori publik nuk merr pjesë, drejtpërdrejt apo tërthorazi. Për efekt të këtij ligji, çdo lloj garancie, financiare apo e ndonjë forme tjetër, e dhënë nga sektori publik, vlerësohet si pjesëmarrje e këtij sektori në investimin privat.

14. **“Agjencia e Prokurimit Publik”**, është agjencia e ngritur dhe që funksionon sipas ligjit nr. , datë , “Për prokurimin publik”.

15. **“Avokati i prokurimeve”**, është institucioni i ngritur dhe që funksionon sipas ligjit nr. , datë , “Për prokurimin publik”.

16. **“Bashkimi i përkohshëm i shoqërive”**, është marrëveshje e shkruar ndërmjet 2 ose më shumë personave juridikë, që ka për objekt kryerjen e një veprimtarie të caktuar, ku përcaktohet roli i secilës palë dhe ku njëra prej tyre përcaktohet si shoqëri kryesuese, që përfaqëson bashkimin në nënshkrimin e kontratës dhe në çdo nismë tjetër.

17. **“Vlera për para”**, është një term, që përdoret për të përcaktuar nëse një autoritet kontraktues ka arritur përfitimin maksimal nga mallrat apo shërbimet, që merr

(vijon në faqen 14)

## Projektligji "Për Koncesionet"

(vijon nga faqja 13)

dhe/ose jep, në shfrytëzim brenda burimeve, që zotëron. Ky term jo vetëm mat vlerën e mallrave apo të shërbimeve, por vlerëson cilësinë, koston, shfrytëzimin e burimeve, përshtatshmërinë me qëllimin, kohën dhe mundësinë për të vendosur që, të gjitha së bashku, të përbëjnë vlerën më të mirë ekonomike.

*Neni 3*

*Objekti i ligjit*

Ky ligj përcakton kushtet, mënyrat, kriteret dhe procedurat e dhënies së koncesioneve në Republikën e Shqipërisë.

*Neni 4*

Fusha e zbatimit të koncesioneve

1. Ky ligj zbatohet për dhënien e koncesioneve nga autoritetet kontraktuese për veprimtaritë ekonomike, për projektet e koncesionit në këta sektorë:

a) në transport (hekurudhat, transportin hekurudhor, portet, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, parkimet, transportin publik);

b) në prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike e të ngrohjes;

c) në prodhimin, shpërndarjen dhe administrimin e ujit, në trajtimin, mbledhjen, shpërndarjen dhe administrimin e ujërave të zeza, ujitjen, drenazhimin, pastrimin e kanaleve e të digave;

ç) në grumbullimin, transportimin, përpunimin, administrimin e mbetjeve të ngurta;

d) në telekomunikacion;

dh) në arsim dhe sport;

e) në shëndetësi;

ë) në turizëm dhe kulturë;

f) në infrastrukturën e burgjeve;

g) në projektet e riciklimit të tokës, në parqet industriale, të strehimit, të ndërtesave qeveritare, shërbimeve të mirëmbajtjes së teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturës së bazës të së dhënave.

gj) në shpërndarjen e gazit natyror;

h) në kontratat e administrimit apo në kryerjen e shërbimeve publike, përfshirë edhe ato të sektorëve të sipërpërmendur.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, autorizon zbatimin e koncesioneve edhe në sektorë të tjerë.

3. Në raste të veçanta, për nxitjen e investimeve në sektorë e përmendur në pikën 1, të këtij neni apo për sektorë të tjerë parësorë në zhvillimin ekonomik të vendit, në përputhje me objektivat strategjike, Këshilli i Ministrave mund t'u ofrojë investitorëve, vendas apo të huaj, koncesione me çmimin simbolik 1 euro. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, miraton listën e asetëve, që do të jepen në koncesion, për efekt të zbatimit të kësaj pike.

4. Ky ligj nuk zbatohet për lëshimin e licencave, përveçse në masën që një licencë lëshohet brenda kuadrit të kontratës së koncesionit.

5. Ky ligj nuk zbatohet për prokurimet publike të shërbimeve, mallrave dhe ndërtimeve, si dhe për investimet private.

*Neni 5*

*Autoriteti kontraktues*

1. *Autoriteti kontraktues është ministria apo njësi e qeverisjes vendore, që, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, është përgjegjëse për veprimtarinë ekonomike, për të cilën jepet koncesioni.*

2. *Autoriteti kontraktues për koncesionet vendore është autoriteti përgjegjës i njësisë të qeverisjes vendore.*

3. *Këshilli i Ministrave përcakton autoritetin kontraktues për çdo koncesion, pas identifikimit të koncesioneve të mundshme, sipas nenit 11, të këtij ligji.*

4. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve, për plotësimin e qëllimit dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji, si dhe dokumentet standarde në fushën e koncesioneve.

*Neni 6*

*Agjencia e Prokurimit Publik*

1. Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave koncesionare dhe shqyrtimi administrativ i ankesave ndaj tyre bëhen nga Agjencia e Prokurimit Publik.

2. Në ushtrim të funksioneve për koncesionet, Agjencia e Prokurimit Publik ka këto kompetenca:

a) U kërkon autoriteteve kontaktuese raportime periodike, një herë në 6 muaj, për gjendjen e koncesioneve.

b) Verifikon zbatimin e procedurave koncesionare, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera, të dala në zbatim të tij, duke u kërkuar autoriteteve koncesionare të gjithë informacionin e nevojshëm.

c) Propozon masa disiplinore dhe vendos gjoba në masën e përcaktuar në legjislacionin e prokurimeve, në rastet kur vëren shkelje të procedurave të këtij ligji.

ç) Bën shqyrtimin administrativ të ankesave të ofertuesve në lidhje me procedurat e koncesionit.

d) Vendos dhe shpall përjashtimin nga procedurat koncesionare të ofertuesve, që gjatë një procedure koncesionare, kanë depozituar dokumentë false apo kanë deklaruar informacion të rreme.

e) I jep Këshillit të Ministrave mendim për procedurën e ndjekur për koncesionet.

*Neni 7*

*Avokati i prokurimeve*

1. Monitorimi i zbatimit të këtij ligji dhe i akteve nënligjore, të dala në bazë dhe në zbatim të tij, gjatë kryerjes së procedurave koncesionare, në mbrojtje të interesave të ligjshme të ofertuesve, bëhet nga avokati i prokurimeve.

(vijon në faqen 15)



## Projektligji "Për Koncesionet"

(vijon nga faqja 14)

2. Në ushtrimin e funksioneve sipas këtij ligji, avokati i prokurimeve ka këto kompetenca:

a) Shqyrton ankesat e personave të interesuar, për veprime apo mosveprime të kundërligjshme të autoritetit kontraktues.

b) Fillon hetimin administrativ kur vëren se rasti përbën shkelje të këtij ligji.

c) Në përfundim të hetimit administrativ informon autoritetin kontraktues dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për rezultatet e hetimit.

3. Avokati i prokurimeve, brenda 5 ditëve nga fillimi i hetimit njofton personat e interesua dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për këtë fakt.

4. Gjatë ushtrimit të funksioneve për hetimin administrativ, avokati i prokurimeve mund;

a) të këqyrë në vend akte dhe dokumente, që kanë lidhje me çështjen në hetim.

b) Të kërkojë informacione dhe shpjegime nga administrata shtetërore apo të marrë në pyetje çdo person të lidhur me çështjen në hetim, si dhe të kërkojë ekspertizë nga të tretët.

c) Të rekomandojë ndryshimin e ligjit dhe akteve, të dala në zbatim të tij, kur vëren se përmbajtja e këtyre akteve krijon mundësi për shkeljen e procedurave koncesionare.

*Neni 8*

*Njësia e Trajtimit të Koncesioneve*

Njësia e Trajtimit të Koncesioneve ngrihet në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, për të nxitur dhe asistuar autoritetin kontraktues në vlerësimin dhe negociimin e koncesioneve.

### **KREU II**

#### **IDENTIFIKIMI I KONCESIONEVE TË MUNDSHME DHE PËRZGJEDHJA E KONCESIONARIT**

*Neni 9*

*Identifikimi i koncesioneve të mundshme*

1. Identifikimi i koncesioneve të mundshme bëhet nga ministritë përgjegjëse ose organet e njësive të qeverisjes vendore, në bashkëpunim me Njësinë e Trajtimit të Koncesioneve.

Koncesionet e mundshme mund të identifikohen edhe nga një propozues, nëpërmjet propozimeve të pakërkua, në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 23, të këtij ligji.

2. Ministritë përgjegjëse ose organet e njësive të qeverisjes vendore, në bashkëpunim me Njësinë e Trajtimit të Koncesioneve, kryejnë analizën e rentabilitetit dhe të përshtatshmërisë financiare, për të vendosur nëse duhet të zbatohet një koncesion i mundshëm. Kjo analizë bazohet në parimet e vlerës për para, në përputhshmërinë e koncesioneve të mundshme me objektivat strategjike kombëtare dhe objektivat strategjike të sektorit, në rentabilitetin, teknik dhe tregtar, të koncesion-

it të mundshëm dhe aftësinë e tij për të tërhequr koncesionarë të mundshëm dhe financime private.

*Neni 10*

*Fazat e përzgjedhjes*

1. Koncesionarët përzgjidhen nëpërmjet një procedure parakualifikuese, që shoqërohet me një kërkesë për propozim, të parashikuar në nenet 11 deri 21, të këtij ligji. Përfundim nga ky rregull bëjnë koncesionet e dhëna sipas pikës 2, të këtij neni, dhe të nenit 23, të këtij ligji.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i bërë në pikën e mësipërme, autoriteti kontraktues ka të drejtë të kërkojë propozime nga të gjithë ofertuesit e mundshëm, pa një procedurë parakualifikuese, nëse e vlerëson se nuk është e nevojshme kryerja, në këtë rast, e procedurës parakualifikuese.

*Neni 11*

*Procedura e përzgjedhjes paraprake*

1. Autoriteti kontraktues përgatit ftesën për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes paraprake dhe dokumentet e parakualifikimit, me qëllim identifikimin e ofertuesve, që kanë kualifikimin e nevojshëm për të zbatuar koncesionin.

2. Ftesa për të marrë pjesë në procedurën e përzgjedhjes paraprake botohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në shtypin, ndërkombëtar dhe vendas.

3. Ftesa për të marrë pjesë në procedurën e përzgjedhjes paraprake përfshin këto të dhëna:

a) një përshkrim i shkurtër i mjetit infrastrukturor;

b) tregues për elementet thelbësore të koncesionit, si shërbimet, që duhet të bëhen nga koncesionari, mënyrat e financimit të koncesionit, të parashikuara nga autoriteti kontraktues (për shembull, fondet që do të përdoren, nëse janë tërësisht nga tarifat ose pagesat e përdoruesve, apo koncesionarit mund t'i jepet fonde publike, të tilla si pagesa të drejtpërdrejta, hua ose garanci);

c) një përmbledhje e kushteve kryesore, nëse ka të tilla, të kontratës koncesionare, që do të lidhet;

d) mënyrën dhe vendin e paraqitjes së aplikimit për fazën parakualifikuese, si dhe afatin ligjor për dorëzimin, të shprehur në datën dhe orën e caktuar, duke u dhënë kohë të mjaftueshme ofertuesve për të përgatitur dhe dorëzuar aplikimet e tyre;

e) mënyrën dhe vendin e marrjes së dokumenteve të fazës parakualifikuese.

*Neni 12*

*Dokumentet e fazës parakualifikuese*

a) kriteret parakualifikuese, në përputhje me nenin 13, të këtij ligji;

b) pjesëmarrjen e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, në përputhje me nenin 12, të këtij ligji;

c) çdo kërkesë për domosdoshmërinë për të krijuar një person juridik nga ofertuesi i shpallur fitues, sipas ligjeve në fuqi.

(vijon në faqen 16)

## Projektligji "Për Koncesionet"

(vijon nga faqja 15)

*Neni 13*

*Kriteret parakualifikuese*

1. Ofertuesit e interesuar, për të marrë pjesë në një procedurë përzgjedhëse, duhet të plotësojnë disa kriterë objektive, të cilat autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme për një procedurë të caktuar.

Kriteret përcaktohen në dokumentet parakualifikuese dhe përfshijnë të paktën:

a) kualifikimet, profesionale dhe teknike, burimet njerëzore, makineritë dhe asetet e tjera të nevojshme, për të kryer të gjitha fazat e projektit koncesionar, përfshirë projektimin, ndërtimin, operimin dhe, kur është e nevojshme, edhe mirëmbajtjen;

b) aftësitë e mjaftueshme për të administruar fondet financiare të projektit dhe aftësinë për të financuar projektin;

c) kapacitetet e duhura, administruese dhe organizative, besueshmërinë dhe përvojën në zhvillimin e projekteve të ngjashme.

2. Ofertuesit e interesuar kualifikohen për të marrë pjesë në procedurë përzgjedhëse, kur:

a) nuk janë subjekt i një procedure falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrollueshëm apo përfundimi të veprimtarisë ose i çdo situatë tjetër, që, sipas ligjeve në fuqi, sjell si pasojë procedura të të njëjtit karakter;

b) nuk janë shpallur fajtorë për paraqitjen e dokumenteve të rreme.

*Neni 14*

*Pjesëmarrja e bashkimit të përkohshëm të shoqërive*

1. Autoriteti kontraktues, para se t'i ftojë ofertuesit në fazat përzgjedhëse, duhet t'i lejojë ata të formojnë bashkime të përkohshme shoqërishe. Përveç se kur në dokumentet e parakualifikimit parashikohet ndryshe, të dhënat e kërkuara për anëtarët e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, për kualifikimet e tyre, në përputhje me parashikimet e këtij neni, duhet t'i referohen bashkimit të përkohshëm të shoqërisë, në tërësi, dhe anëtarëve të tij, në veçanti.

2. Secili anëtar i bashkimit të përkohshëm të shoqërisë mund të marrë pjesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, vetëm në një bashkim të përkohshëm shoqërishe, në të njëjtën kohë. Shkelja e kësaj dispozite sjell skualifikimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërisë dhe të anëtarit të këtij bashkimi shoqërishe.

*Neni 15*

*Vendimi për parakualifikimin*

Autoriteti kontraktues bën kualifikimin e secilit ofertues, që ka paraqitur aplikimin në fazën e parakualifikimit në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentet e parakualifikimit. Autoriteti kontraktues shpall listën e ofertuesve të parakualifikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit. Të gjithë ofertuesit e parakualifikuar ftohen për të paraqi-

tur propozimet, në përputhje me nenet 16 deri 21, të këtij ligji.

*Neni 16*

*Procedurat për propozimet e kërkuara*

1. Procedurat për propozimet e kërkuara zhvillohen me 1 ose 2 faza.

2. Autoriteti kontraktues, kundrejt pagimit të tarifës që mund të aplikojë, u jep ofertuesve të parakualifikuar kërkesën për propozim dhe dokumentet e tjera përkatëse, në përputhje me nenin 5, të këtij ligji, apo dokumente të tjera, që gjykohen të nevojshme. Në rast se procedurat e parakualifikimit nuk zbatohen, kërkesa për propozim u bëhet të gjithë ofertuesve të mundshëm.

3. Pavarësisht nga sa më sipër, autoriteti kontraktues, mund të përdorë procedurën me dy faza, për të kërkuar propozime nga ofertuesit, nëse elemente të tilla të projektit të koncesionit, si specifikimet e projektit, treguesit e performancës, mënyrat e financimit apo kushtet kontraktuale, nuk mund të përshkruhen në kërkesën për propozim në mënyrë aq të hollësishme dhe të saktë, që të lejojnë ofertuesit për të paraqitur propozimet e tyre përfundimtare.

4. Nëse vendoset procedura me dy faza, zbatohen këto dispozita:

a) Kërkesa fillestare për propozime u kërkon ofertuesve të paraqesin, në fazën e parë të procedurës, propozimet fillestare për specifikimet e projektit, treguesit e performancës, kërkesat financiare ose karakteristika të tjera të projektit, si dhe termat kryesore kontraktuale, të propozuara nga autoriteti kontraktues;

b) Autoriteti kontraktues mund të organizojë takime dhe diskutime me çdo ofertues, për të sqaruar çështje në lidhje me kërkesën fillestare, për propozimet ose propozimet fillestare dhe dokumentet përkatëse, të paraqitura nga ofertuesit. Autoriteti kontraktues pasqyron në procesverbale çdo takim apo diskutim për këtë çështje. (Procesverbali përmban çështjet e ngritura dhe sqarimet e dhëna nga autoriteti kontraktues).

c) Pas shqyrtimit të propozimeve, autoriteti kontraktues mund ta rishohë dhe, sipas rastit, ta ndryshojë çdo kërkesë fillestare për propozime, duke hequr apo përshatur çdo aspekt të specifikimeve fillestare të projektit, treguesit e performancës, kërkesat financiare ose karakteristika të tjera të projektit, përfshirë kushtet kryesore kontraktuale dhe çdo kriter për vlerësimin, krahasimin e propozimeve dhe për caktimin e ofertuesit më të mirë, apo mund të shtojë karakteristika a kriteret e tjera. Autoriteti kontraktues shënon në regjistrin e koncesioneve arsyet për çdo rishikim të kërkesës për propozim. Çdo shfuqizim, ndryshim apo shtesë duhet të pasqyrohet në ftesën, për të paraqitur propozimet përfundimtare;

(vijon në faqen 17)

## Projektligji "Për Koncesionet"

(vijon nga faqja 16)

ç) Në fazën e dytë të procedurës, autoriteti kontraktues fton ofertuesit për të paraqitur propozimet përfundimtare për një paketë të vetme specifikesh të projektit, të treguesve të performancës ose kushteve kontraktuale, në përputhje me nenet 17 deri 21, të këtij neni.

*Neni 17*

*Përmbajtja e kërkesës për propozim*

Kërkesa për propozim, e përgatitur nga autoriteti kontraktues, përmban, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

a) Të dhëna të përgjithshme, me qëllim që ofertuesit të përgatisin dhe të paraqesin propozimet e tyre;

b) Specifikimet e projektit dhe treguesit e performancës, sipas rastit, përfshirë edhe kërkesat e autoritetit kontraktues për standardet e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit;

c) Kushtet kontraktuale, të propozuara nga autoriteti kontraktues, përfshirë treguesit për kushtet e panegociueshme;

ç) Kriteret që do të zbatohen për vlerësimin e propozimeve dhe, nëse do të zbatohen, edhe kufijtë minimalë për vlerësimin e propozimeve, peshën përkatëse të çdo kriteri dhe mënyrën, sipas së cilës kriteret dhe kufiri minimal duhet të zbatohen në vlerësimin dhe skualifikimin e propozimeve;

d) Kërkesat për garancinë e ofertës.

*Neni 18*

*Sqarimet dhe modifikimet*

1. Autoriteti kontraktues, me nismën e vet apo si rezultat i një kërkesë për sqarim nga një ofertues, mund të rishohë dhe, sipas rastit, të ndryshojë çdo element të kërkesës për propozim, sipas nenit 17, të këtij ligji.

Çdo ndryshim u njoftohet, menjëherë, të gjithë kandidatëve, që kanë tërhequr dokumentet e garës. Kur autoriteti kontraktues e vlerëson të nevojshme të ndryshojë dokumentet dhe kjo bëhet brenda një periudhe kohe më pak se 1/3 e numrit të ditëve, të përcaktuara për përgatitjen e ofertave, duhet ta shtyjë afatin e fundit të paraqitjes së ofertave për të njëjtën periudhë kohe.

2. Autoriteti kontraktues, në rastin e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, të shënojë në regjistrin e koncesioneve arsyet për çdo rishikim në kërkesën për propozim. Çdo shfuqizim, ndryshim apo shtesë u komunikohet ofertuesve në të njëjtën mënyrë si kërkesa për propozim.

*Neni 19*

*Kriteret e vlerësimit*

1. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve teknike përfshijnë të paktën:

a) qëndrueshmërinë teknike;

b) përputhjen me standardet e mjedisit;

c) efikasitetin në veprim;

ç) cilësinë e shërbimeve dhe të masave, për të siguruar vazhdimësinë e tyre;

d) potencialin e zhvillimit, shoqëror dhe ekonomik, që ofrohet nga propozimet.

2. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve, financiare dhe tregtare, sipas rastit, përfshijnë të paktën:

a) vlerën aktuale të tarifave dhe të çmimeve për njësi të propozuara dhe pagesa të tjera, gjatë periudhës koncesionare;

b) vlerën aktuale të pagesave të drejtpërdrejta të propozuara të bëhen nga autoriteti kontraktues, nëse ka;

c) shpenzimet për projektin dhe veprimtaritë e ndërtimit, shpenzimet për operimin dhe mirëmbajtjen vjetore, vlerën e tashme të investimeve, të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes;

ç) masën e mbështetjes financiare, nëse ka, që pritet të realizohet nga ndonjë autoritet publik i Republikës së Shqipërisë;

d) qëndrueshmërinë dhe rentabilitetin e financimeve të propozuara.

3. Këshilli i Ministrave, për efekt të zbatimit të pikës 3, të nenit 4, të këtij ligji, përcakton edhe kriteret e tjera, që do të merren parasysh në vlerësimin e ofertave. Këto kriteret bazohen në rëndësinë sektoriale të zhvillimit të ekonomisë, vlerën e investimit, nivelin e punësimit, përparësinë për zhvillimin e zonave të veçanta të vendit, tregues të tjerë specifikë të sektorëve, si dhe çmimin apo tarifën e propozuar. Këshilli i Ministrave, në këtë rast, përcakton dhe peshën, që do të këtë çdo kriter në vlerësimin e ofertës.

*Neni 20*

*Krahasimi dhe vlerësimi*

1. Autoriteti kontraktues, krahason dhe vlerëson çdo propozim, në përputhje me kriteret e vlerësimit, peshën relative, që i jepet çdo kriteri në procesin e vlerësimit, të parashikuar në kërkesën për propozim.

2. Për qëllimet e pikës 1, të këtij neni, autoriteti kontraktues mund të vendosë kufij minimalë për cilësinë, aspektet teknike, financiare dhe tregtare. Propozimet, që nuk arrijnë kufijtë minimalë, vlerësohen të papërshtatshëm dhe skualifikohen.

*Neni 21*

*Caktimi i ofertuesit më të mirë dhe negociimet përfundimtare*

1. Autoriteti kontraktues rendit të gjitha propozimet e pranueshme, në bazë të kriterëve të vlerësimit dhe njofton ofertuesit për këtë. Pas njoftimit, të gjithë ofertuesit kanë të drejtë të paraqesin ankesat e tyre, në përputhje me dispozitat e kreut III, të këtij ligji. Me mbarimin e afatit për paraqitjen e ankesave, autoriteti kontraktues fton ofertuesin, që ka marrë vlerësimin më të mirë, për negociime përfundimtare.

2. Kushtet kontraktuale, të deklaruara të panegociueshme në kërkesën përfundimtare për propozime, nuk do të jenë objekt i negociimeve përfundimtare.

3. Nëse për autoritetin kontraktues bëhet e qartë se negociimet me ofertuesin e ftuar nuk do të përfundojnë me një kontratë koncesionare, ai i ndërpret negociimet me këtë ofertues dhe fton ofertuesit e tjerë, sipas ren-

(vijon në faqen 18)



## Projektligji "Për Koncesionet"

(vijon nga faqja 17)

ditjes, derisa të arrihet lidhja e kontratës së koncesionit, ose i refuzon të gjitha propozimet e mbetura. Autoriteti kontraktues nuk mund të rifillojë negociime me një ofertues, me të cilin negociimet janë ndërprerë, në përputhje me këtë pikë.

4. Pas përfundimeve të negociimeve për kontratën koncesionare, Njësia e Trajtimit të Koncesioneve jep, me shkrim, mendim për kushtet e kontratës. Pas marrjes së mendimit dhe nënshkrimit të kontratës së koncesionit, ajo ia paraqitet Këshillit të Ministrave për miratim.

5. Autoriteti kontraktues boton në Buletinin e Njoftimeve Publike emrin e koncesionarit dhe kushtet thelbësore të kontratës së koncesionit, brenda 30 ditëve pas miratimit të saj, në përputhje me përcaktimin e pikës 4, të këtij neni.

*Neni 22*

*Negociimi i kontratave koncesionare pa procedura konkurruese*

1. Autoriteti kontraktues mund të bëjë negociimin e kontratave koncesionare pa procedura konkurruese vetëm me miratimin e Këshillit të Ministrave, nëse:

a) projekti ka të bëjë me mbrojtjen e sigurinë kombëtare dhe nëse një procedurë konkurruese do të paraqiste rrezikshmëri. Vënia në rrezik e mbrojtjes apo sigurisë kombëtare miratohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Sigurimit.

b) kontrata koncesionare është zgjidhur për shkak të një shkeljeje serioze nga ana e koncesionarit dhe kur procedura konkurruese nuk është e mundur të realizohet, për shkak të nevojës urgjente, për të siguruar vazhdimësinë në kushtet e shërbimit.

2. Kohëzgjatja e një kontrate koncesioni, të lidhur sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, nuk duhet të kalojë 12 muaj.

3. Asnjë kontratë koncesionare nuk mund të realizohet sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, përveç se kur autoriteti kontraktues ka filluar një procedurë konkurruese përzgjedhëse për koncesionarin, në përputhje me kushtet e kontratës, të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, apo kur ka vendosur të mos e japë koncesionin, me kalimin e afatit të përcaktuar në kushtet e kontratës.

4. Nëse një kontratë koncesioni negociohet në përputhje me këtë nen, pa përdorur procedurën konkurruese, autoriteti kontraktues duhet:

a) të angazhojë në negociime, sipas rrethanave, aq persona sa e gjykon të nevojshëm për të zbatuar projektin; b) të caktojë kritere të arsyeshme vlerësimi për kërkesat e projektit, në bazë të të cilave do të vlerësohen dhe do të renditen propozimet.

5. Autoriteti kontraktues boton në Buletinin e Njoftimeve Publike emrin e koncesionarit dhe kushtet thelbësore të kontratës së koncesionit brenda 30 ditëve nga data e

miratimit të kontratës së koncesionit nga Këshilli i Ministrave, përveç rasteve kur botimi rrezikon mbrojtjen apo sigurinë kombëtare.

*Neni 23*

*Propozimet e pakërkuara*

1. Autoriteti kontraktues është i autorizuar të shqyrtojë dhe të pranojë propozimet e pakërkuara, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë nen, me kusht që këto propozime të mos kenë të bëjnë me një projekt, për të cilin ka filluar ose është shpallur procedura e përzgjedhjes.

2. Procedurat për përcaktimin e pranueshmërisë së propozimeve të pakërkuara janë këto:

a) Brenda 90 ditëve pas marrjes dhe shqyrtimit fillestar të propozimit të pakërkuar, autoriteti kontraktues përcakton nëse projekti koncesionar paraqet interes publik dhe për këtë vë në dijeni propozuesin;

b) Kur projekti koncesionar paraqet interes publik, autoriteti kontraktues fton propozuesin të paraqesë të dhëna të tjera, të nevojshme, për projektin e propozuar, për të bërë vlerësimin për kualifikimet e propozuesit dhe fizibilitetin, teknik dhe financiar, të projektit;

c) Brenda 120 ditëve nga ftesa e autoritetit kontraktues, propozuesi duhet të paraqesë një studim fizibiliteti, teknik dhe financiar, (duke përfshirë, por pa u limituar në të, një model financiar dhe një plan për financimin e projektit), një studim për ndikimin në mjedis dhe të dhëna të mjaftueshme për konceptin ose teknologjinë e parashikuar në propozim;

ç) Gjatë shqyrtimit të një propozimi të pakërkuar, autoriteti kontraktues respekton pronësinë intelektuale, sekretet tregtare ose të drejtat e tjera ekskluzive, të parashikuara, që rrjedhin apo që përmenden në propozim. Informacionin e dhënë nga/ose në emër të propozuesit për propozimin e pakërkuar, autoriteti kontraktues nuk e përdor pa pëlqimin paraprak të propozuesit, për një periudhë prej 12 muajsh nga data e marrjes së këtij informacioni.

3. Fillimi i një procedure përzgjedhëse bëhet, si më poshtë vijon:

a) Autoriteti kontraktues, brenda 6 muajve nga marrja e dokumentacionit, në përputhje me shkronjën "b", të pikës 2, të këtij neni, vendos për pranimin ose refuzimin e projektit të mundshëm koncesionar, që rrjedh nga propozimi i pakërkuar. Nëse propozimi i pakërkuar pranohet nga autoriteti kontraktues, ai fillon një procedurë përzgjedhëse konkurruese, në përputhje me nenet 11 deri 21, të këtij ligji, ndërsa kur propozimi refuzohet dhe palët nuk bien dakord ndryshe, autoriteti kontraktues, i kthen propozuesit dokumentet origjinale dhe fotokopjet e dokumenteve të paraqitura.

b) Propozuesi ftohet të marrë pjesë në procedurën përzgjedhëse konkurruese, në përputhje me shkronjën

(vijon në faqen 19)

## Projektligji “Për Koncesionet”

(vijon nga faqja 18)

“a”, të pikës 3, të këtij neni, dhe, me vendim të Këshillit të Ministrave, atij i jepet një bonus për rezultatin, teknik dhe/ose financiar, të arritur gjatë procedurës përzgjedhëse konkurruese deri në një maksimum 10 për qind të pikëve. Identiteti i propozuesit, ekzistenca dhe shuma e bonusit tregohen në dokumentet e procedurës përzgjedhëse konkurruese.

*Neni 24*

### *Konfidencialiteti*

Autoriteti kontraktues i trajton propozimet në mënyrë që të mënjanohet përhapja e tyre tek ofertuesit konkurrues. Çdo diskutim, komunikim dhe negociim, ndërmjet autoritetit kontraktues, Njësisë së Trajtimit të Koncesioneve dhe një ofertuesi, mbeten konfidenciale. Nëse nuk parashikohet me ligj, me vendim gjykate apo nga kërkesa për propozim, asnjëra palë në bisedime nuk i deklaron asnjë personi tjetër asnjë informacion teknik për çmimin apo çdo gjë tjetër për diskutimet, komunikimet dhe bisedimet, në përputhje me dispozitat e mësipërme, pa pëlqimin e palës tjetër.

### **KREU III**

#### **PROCEDURAT E RISHIKIMIT ADMINISTRATIV**

*Neni 25*

##### *Procedura e ankimit*

1. Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të përzgjedhjes, kur gjykon se një veprim i ndërmarrë nga autoriteti kontraktues është në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji apo të akteve të tjera, ligjore dhe nënligjore, për procedurat e koncesionit.

2. Ankesa paraqitet tek Agjencia e Prokurimit Publik, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e botimit të njoftimit të kandidatëve të parakualifikuar apo e njoftimit të renditjes së ofertuesve nga autoriteti kontraktues.

3. Me marrjen e ankesës Agjencia e Prokurimit Publik njofton brenda 5 ditëve autoritetin kontraktues në lidhje me pezullimin e procedurave koncesionare dhe fillimin e procedurave të hetimit administrativ.

4. Agjencia e Prokurimit Publik nuk pezullon procedurën koncesionare në rastet kur:

a) nga shqyrtimi paraprak rezulton se ankesa nuk është e argumentuar juridikisht.

b) pezullimi do të vinte në kundërshtim me interesin publik apo do të dëmtonte autoritetin kontraktues a ofertuesit e tjerë.

5. Gjatë shqyrtimit të ankesës, deri përpara lidhjes së kontratës, Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të shfuqizojë, pjesërisht apo plotësisht, vendimet apo aktet e autoritetit kontraktues.

b) ta udhëzojë autoritetin kontraktues për korrigjimin e shkeljeve përpara vazhdimit të procedurave koncesionare.

6. Agjencia e Prokurimit Publik, gjatë procedurave të hetimit administrative, ka të gjitha kompetencat e parashikuara nga legjislacioni i prokurimit.

7. Ankesa në Agjencinë e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Agjencia e Prokurimit Publik e shqyrton ankesën, në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij, dhe Kodin e Procedurave Administrative.

8. Agjencia e Prokurimit Publik, brenda 20 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankesës, përfundon hetimin administrativ dhe njofton autoritetin kontraktues dhe ankuesin për vendimin.

9. Vendimi i Agjencisë së Prokurimit Publik është akti administrativ përfundimtar.

*Neni 26*

### *Ankimi në gjykatë*

Kundër vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, ankuesi ka të drejtë që, brenda 30 ditëve nga marrja dje-ni, të bëjë padi, për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative, në gjykatën e rrethit gjyqësor, Tiranë, (seksioni administrativ).

Gjykata kryen shqyrtimin gjyqësor, sipas procedurave dhe brenda afateve të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, kreu II, “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Shqyrtimi i këtij ankimi në gjykatë nuk pezullon vazhdimin e procedurave të koncesionit.

### **KREU IV**

#### **KONTRATA KONCESIONARE**

*Neni 27*

##### *Përmbajtja*

Kontratat e koncesionit parashikojnë ato çështje, që vlerësohen të përshtatshme nga palët, të tilla si:

a) Natyra dhe objekti i punëve, që duhet të kryhen, dhe shërbimet, që duhet të jepen nga koncesionari;

b) Kohëzgjatja e kontratës së koncesionit, që përshtatet me specifikën e koncesionit përkatës, por që nuk i kalon 35 vjet, dhe kushtet, nëse ka, për zgjatjen e saj;

c) Ndihma, që mund t’i japë autoriteti kontraktues dhe Njësia e Trajtimit të Koncesioneve koncesionarit për marrjen e licencave dhe të lejeve, të nevojshme për koncesionin;

ç) Çdo kërkesë për themelimin dhe kapitalin themeltar të një personi juridik, që duhet të krijohet nga ofertuesi i shpallur fitues, në bazë të ligjeve në fuqi, si dhe ndalimin për transferimin e aksioneve apo të pjesëve të kapitalit të kësaj shoqërie, pa pëlqimin paraprak të autoritetit kontraktues;

d) Pronësia e aseteve të projektit të koncesionit dhe detyrimet e palëve, sipas rastit, për vënien në dispozicion të vendit të projektit të koncesionit dhe çdo lehtësi tjetër, të mundshme;

(vijon në faqen 20)

## Projektligji "Për Koncesionet"

(vijon nga faqja 19)

dh) Shpërblimi i koncesionarit, pavarësisht nëse përbëhet nga tarifa apo pagesa për përdorimin e mjetit të infrastrukturës ose realizimit të shërbimeve, metodat dhe formulat, për caktimin ose rregullimin e këtyre tarifave apo pagesave, si dhe, nëse zbatohen, pagesat, që mund të bëhen nga autoriteti kontraktues ose një autoritet tjetër publik;

e) Procedurat për rishikimin dhe miratimin e projekteve inxhinierike, të planeve të ndërtimit dhe specifikimeve nga autoriteti kontraktues, si dhe procedurat për testimin e kontrollit përfundimtar, miratimin dhe pranimin e mjetit të infrastrukturës, rregullat dhe standardet, në bazë të të cilave janë projektuar projektet koncesionare, që duhet të jenë në përputhje me praktikën më të mirë, me synim zhvillimin e tregut, nëpërmjet alokimit të kujdesshëm të riskut;

ë) Shtirja e detyrimeve të koncesionarit, sipas rastit, për të siguruar ndryshimin e shërbimit, për të përmbushur kërkesat e kohës, vazhdimësinë e tij dhe dhënien, në kushte kryesisht të njëjta për të gjithë përdoruesit, mekanizmat për të trajtuar kostot e mundshme për to;

f) E drejta e autoritetit kontraktues ose e një autoriteti tjetër publik për të monitoruar punët, që duhet të kryhen, dhe shërbimet, që duhet të jepen nga koncesionari, kushtet dhe masën, në të cilën autoriteti kontraktues mund të urdhërojë ndryshime për punët dhe kushtet e shërbimit. E drejta e autoritetit kontraktues për të marrë masa të tjera, të arsyeshme, për të siguruar që mjeti infrastrukturor të operohet si duhet dhe shërbimet të jepen në përputhje me kërkesat e zbatueshme, ligjore dhe kontraktuale, si dhe e drejta për të monitoruar mekanizmat dhe trajtimin e shpenzimeve të mundshme për to;

g) Detyrimet e koncesionarit për t'i dhënë autoritetit kontraktues apo një autoriteti tjetër publik, sipas rastit, raporte dhe informacion tjetër për veprimtarinë;

gj) Çdo kufizim ose kusht, të zbatueshëm për transferimin e të drejtave dhe të detyrimeve të koncesionarit, sipas kontratës së koncesionit;

h) Çdo kufizim ose kusht për transferimin e një interesi kontrollues të koncesionari;

i) Përkufizimi dhe pasoja e forcës madhore, ndryshimi në ligj dhe ndryshime të tjera në rrethana (duke përfshirë çdo të drejtë të palëve për të kërkuar kompensimin ose rishikimin e kontratës së koncesionit);

j) Detyrimet e mundshme, nëse ka, të autoriteteve publike përkatëse ose të autoritetit kontraktues;

k) Rrethanat, në të cilat autoriteti kontraktues ka të drejtën të marrë përsipër, përkohësisht, administrimin e mjetit të infrastrukturës, për sigurimin e një shërbimi, të efektshëm dhe të pandërprerë, dhe, në rastin e dështimit nga koncesionari, të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale dhe të dështimit të tij, për të rregulluar shkeljen e kontratës;

l) Çdo të drejtë të autoritetit kontraktues, për të rishikuar dhe miratuar kontratat kryesore, që duhet të lidhen nga koncesionari, veçanërisht me aksionerët e koncesionarit ose persona të tjerë juridikë, ku koncesionari është pjesëmarrës, apo anasjelltas;

ll) Garancitë për t'u përmbushur dhe politikat e siguri-meve, që duhet të ndiqen nga koncesionari për zbatimin e koncesionit;

m) Procedurat e rregullimit të shkeljes së kontratës, të bërë nga njëra prej palëve;

n) Kushtet dhe procedurat për ndryshimin dhe/apo përfundimin e kontratës; të drejtat dhe detyrimet e palëve, me kalimin e afatit apo përfundimin e kontratës (duke përfshirë mekanizmin e transferimit të sendeve pasurore, të teknologjisë, kompensimit, shërbimit e trajnimit dhe të mbështetjes, që duhet të jepet nga koncesionari);

nj) Ligji i zbatueshëm dhe mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që mund të lindin ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit;

o) Të drejtat dhe detyrimet e palëve për informacionin konfidencial.

*Neni 28*

*Zgjidhja e kontratës së koncesionit*

1. Autoriteti kontraktues, nëse nuk parashikohet ndryshe në kontratën e koncesionit, mund ta zgjidhë kontratën kur:

a) ka arsye të mendojë se koncesionari nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet, për shkak të paaftësisë paguese, shkeljeve serioze apo të rasteve të tjera, që pengojnë apo nuk bëjnë të mundur vazhdimin e kontratës së koncesionit;

b) koncesionari dështon në sigurimin e financimit të projektit, brenda 12 muajve nga nënshkrimi i kontratës së koncesionit.

2. Secila palë, nëse nuk është parashikuar ndryshe në kontratën e koncesionit, ka të drejtë ta zgjidhë kontratën kur:

a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave, që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;

b) ka shkelje serioze nga pala tjetër, e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar në kontratën e koncesionit.

3. Palët kanë, gjithashtu, të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm.

**KREU V**

**FINANCIMI**

*Neni 29*

*Masat financiare*

1. Koncesionari ka të drejtë të vendosë, të marrë ose të mbledhë tarifa apo të ardhura të tjera për përdorimin e aseteve ose të shërbimeve të realizuara prej tij, në përputhje me kontratën e koncesionit, e cila parashikon mënyrat dhe formulat e caktimit e të ndryshimit të këtyre tarifave ose pagesave.

2. Autoriteti kontraktues ka të drejtë t'i bëjë koncesionarit pagesa të drejtpërdrejta, si zëvendësim apo si shpëtim të tarifave a pagesave për përdorimin e aseteve ose të shërbimeve të realizuara prej tij.

**KREU VI**

**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE LIGJI I ZBATUESHËM**

*Neni 30*

*Ligji i zbatueshëm*

(vijon në faqen 15)



## Projektligji “Për Koncesionet”

(vijon nga faqja 13)

1. Kontrata e koncesionit u nënshtrohet ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Koncesionari, aksionerët e tij dhe ortakët e tjerë të veprimtarisë së tij ekonomike janë të lirë të zgjedhin ligjin, që rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre.

### Neni 31

#### Mosmarrëveshjet ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit

1. Çdo mosmarrëveshje, ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit, zgjidhet me mekanizmat e përcaktuara në kontratën e koncesionit, për të cilat palët kanë rënë dakord, përfshirë edhe procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar.

2. Koncesionari, aksionerët e tij dhe ortakët e tjerë të tij janë të lirë të zgjedhin mekanizmat e përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

### KREU VII

#### DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 32

#### Shfuqizime

Ligji nr.7973, datë 26.7.1995, “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

### Neni 33

#### Periudha tranzitore deri në krijimin e Njësisë së Trajtimit të Koncesioneve

Deri në krijimin e Njësisë së Trajtimit të Koncesioneve, në përputhje me nenin 8, të këtij ligji, dhe bërjes së saj plotësisht operacionale, përgjegjësitë dhe kompetencat do t'i ushtrojë ministria përgjegjëse për ekonominë.

### Neni 34

#### Ligjet ekzistuese për fusha specifike

1. Në rast mospërputhjeje me ligjet ekzistuese, ky ligj mbizotëron mbi të gjitha ligjet e tjera për koncesionet.

2. Të gjitha ligjet për sektorë të veçantë duhet t'i rregullojnë koncesionet në përputhje me këtë ligj.

### Neni 35

#### Kontratat e koncesionit, që janë nënshkruar

Ky ligj nuk zbatohet për kontratat e koncesionit, të nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kontratat nuk mund të ripërsëriten ose shtyhen, veçse në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

### Neni 36

#### Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Bashkëpunëtorë për marrjen e informacionit mbi veprimtarinë e Qeverisë dhe të Kuvendit	Alma Kondakçiu Ditmir Bushati Denis Gila Filip Lako
Stafi i Projektit	Sokol Berberi Denada Breshanaj Milaim Demnushaj

Qendra e Studimeve Parlamentare  
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15  
Tiranë-Shqipëri Tel/Fax: +355 4 240 214;  
[cps@albaniaonline.net](mailto:cps@albaniaonline.net);  
[www.ascdpd.org](http://www.ascdpd.org)

## Takimi 15-të i Grupit Konsultativ

### BE - SHQIPËRI

### Draft axhenda

## 1. Fjala e hapjes dhe miratimi i axhendës

## 2. Përgatitja e Zgjedhjeve Vendore

## 3. Sistemi Gjyqësor

## 4. Lufta Kundër Korrupsionit

## 5. Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit

## 6. Policia

## 7. Pastrimi Parave

## 8. Lufta kundër drogës

## 9. Vizat, kontrolli kufijve, azili dhe migracioni

*(Bashkangjitur buletinit do të gjeni materialin përfundimtar të këtij takimi)*

Collaborators for the information on Government and Assembly activities	Alma Kondakçiu Ditmir Bushati Denis Gila Filip Lako
Project Staff	Sokol Berberi Denada Breshanaj Milaim Demnushaj

Centre for Parliamentary Studies  
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15  
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;  
[cps@albaniaonline.net](mailto:cps@albaniaonline.net);  
[www.ascdpd.org](http://www.ascdpd.org)